

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 206, Dhjetor 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjin"
dhe redaksia e gazetës ju urojnë të gjithëve
për shumë vjet **KRISHTLINDJEN** dhe **VITIN E RI**

GËZUAR

**REALIZIMET E VITIT 2020,
PAVARËSISHT SITUATËS SË
PANDEMISË, MENDOJMË SE
DO TË JENË NJË BAZË NISJE
E MIRË, PËR TË VIJUAR
REALIZIMIN E MISIONIT TË
SHOQATËS, NË VITIN 2021**

Anëtar të shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dukagjinas dhe simpatizantë të tyre, Dita e lindjes së Jezuesit po vjen dhe ardhë i bardhe, se me siguri do të lind një ditë e re për ne dukagjinastë e gjithë shqiptaret kudo janë. Të dashur, viti 2020, po mbyllet, edhe pak ditë janë, i cili jo me pak probleme po mbyllet dhe që vijojnë të jene prezentë për efekt të Pandemisë. Jo pak anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", veprimtar e simpatizant të saj u ndanë nga jeta, në mes tyre, Marash Kola, Mhill Toka, poeti Lazer Preka, Vat Preka, Dode e Kole Progni, Nikoll Bregu, Gjelosh Luca, Toka e Martin Molla, Ndoc Selimi e Zef Fusha, Leke Guri, ...

KIRI - HISTORIA, NJERZIT DHE BUKURITË E NATYRËS

Doli në qarkullim libri "KIRI", me autore Prele e Mri Kroj, pas një pune dhe përkushtim disavjeçar. Prele Kroj aktiviste e kontribuues i shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe i nderuar me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini". Mri Kroj, anëtare themeluese e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe e nderuar me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini".

**DOKUMENTI I STEFANO GASPARIT
I VITIT 1671, HISTORIKU I
SHKRUARJES DHE I PUBLIKIMIT
TË TIJ. MARK PALNIKAJ SJELL
PËR LEXUESIT "RELACIONE PËR
GJENDJEN E SHQIPËRISË NË
SHEKULLIN XVII-XVIII"**

Nga Mark Palnikaj

Dokumenti i Stefano Gasparit (Shtjefën Gasprit) i vitit 1671 konsiderohet si më i rëndësishmi për Historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. Në të gjitha rastet kur është komentuar është cilësuar si "Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1671". Në të vërtetë nuk është një relacion në kuptimin zyrtar të tij.

Pas krijimit në Vatikan, në vitin 1622, të institucionit për përhapjen e fesë e quajtur Propaganda Fede, njëri nga vendimet ka qënë detyrimi për klerikët që punonin brënda kontinentit European të dërgonin çdo vit nga një relacion për gjendjen në teritorin që ata administrojnë nga ana fetare. Ata që punonin në vende të tjera jashtë Europës, duhej detyrimisht të dërgonin një relacion së paku një herë në dy vjet.

Relacioni nuk mund të hartohej sipas dëshirës së njërit apo tjetrit klerik, por ishte formuluar një listë me 27 kërkesa, të cilat duhej të dërgoheshin të dhëna.



REALIZIMET E VITIT 2020, PAVARËSISHT SITUATËS SË PANDEMISË, MENDOJMË SE DO TË JENË NJË BAZË NISJE E MIRË, PËR TË VIJUAR REALIZIMIN E MISIONIT TË SHOQATËS, NË VITIN 2021

Anëtar të shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dukagjinat dhe simpatizantë të tyre, Dita e lindjes së Jezuesit po vjen dhe ardhë i bardhe, se me siguri do të lind një dite e re për ne dukagjinat e gjithë shqiptaret kudo janë.

Të dashur, viti 2020, po mbyllet, edhe pak dite janë, i cili jo me pak probleme po mbyllet dhe që vijojnë të jene prezentë për efekt të Pandemisë. Jo pak anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", veprimtar e simpatizant të saj u ndanë nga jeta, në mes tyre, Marash Kola, Mhill Thaçina, poeti Lazer Preka, Vat Preka, Dode e Kole Progni, Nikoll Bregu, Gjelo Luca, Dede Toka e Martin Molla, Ndoc Selimi e Zef Fusha, Leke Guri, kampioni Mark Vata e Gjeto Çezma, familjeve të cilëve ju shprehim ngushëllimet tona të sinqerta, ju paçin lanë jetën e mbarësinë! I përjetshëm qofte kujtimi i tyre!

Megjithatë, në këto kushte edhe kemi përgatitur e zhvilluar disa veprimtari.

Ato janë:

Së pari, botimi gazetës "Dukagjini" ka vijuar të botohet në çdo muaj, në saj të punës së palodhur të redaksisë së gazetës me ne krye Suela Ndoja e më vonë të Luigj Shyti, Ne këtë muaj, del numri 206 i saj. Me rastin e daljes së numrit 200 të saj, u pate planifikuar të behet një veprimtari, por masat kundër Covid-19, nuk na lejuan ta zhvillojmë.

Për botimin e saj, është dhe kontributi i pakursyer të dukagjinave kudo ndodhur, si Kujtim Funiçi, me banim ne Nju-Jork, Zef Nika e Gjergj Guri, ne Bruksel, Nikolin Gjelooshi në Itali, Gjergj Leqezja, Agim Gila (Martini), Agron Hasanaj, Fran Shytani e bar-restorant "ELITA", Anton Kosteri e mj. Ndue Nika, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë, me urimin popullor "Paçi e dhënçi!

Së dyti, me datën 15 shkurt 2020, në mjediset e bibliotekës së qytetit "Marin Barleti", Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me Shoqatën e shkrimtarëve Shkodër, dhe bibliotekën "Marin Barleti" organizoi ceremoninë për paraqitjen e librit "Tre të shoshjanët", të autorit At' Daniel Gjeçi. Në këtë ceremoni morën pjesë shkrimtarë, poetë, historianë e dashamirë të librit. Kjo vepër është botuar nga biblioteka françeskane "At' Gjergj Fishta", e cila ka meritën e veçantë. Por dhe nën kujdesin e studiuesit, poetit e publicistit Prelë Milani. Të dy palët i falënderojmë!

Së treti, me temë: "Lufta kundër kriminalitetit kërkon mobilizim e të gjithëve dhe jo vetëm e policisë", me date 29 shkurt 2020, në bashkëpunim me drejtorinë e policisë në Shkodër, bashkinë Shkodër dhe Prefekturën e Qarkut Shkodër, organizuam një tryezë të rrumbullakët në lidhje me punën që duhet bërë për eliminimin e drogës dhe

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 204, Tetor 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, Internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

veprimtarinë kriminale në krahinën e Dukagjinit, qëllimi i të cilës ishte: "Të bëhen përpjekje për të parandaluar mbjelljen e përdorimin e lëndëve narkotike, ti shmangemi sa të jete e mundur nga kjo e keqe e madhe".

Së katërti, me datën 8 mars 2020, në

mjediset e Muzeut Kombëtar Tiranë, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Dega Tiranë, organizoi një veprimtari në kuadrin e festave të 7 e 8 marsit. Morën pjesë anëtarë të shoqatës e të ftuar. Ndryshe nga herët e tjera ishte një pjesëmarrje më e madhe e zonjave dhe zonjushave

që kishin vlerësuar më së miri këtë veprimtari. Në mes të tjerave u theksua: "Më shumë se sa fjala e shkruar apo e folur, është shembulli ai që udhëheq botën. Mund të vihet në dyshim çiltërsia e fjalës, por s'ka se si të mos besohet shembulli i dhënë. Fjala është e diskutueshme, shembulli flet vetë. Tri gjera nuk mund të kthehen kurrë mbrapsht: Fjala e thënë, shigjeta e lëshuar dhe e kaluara ...! Prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm në edukimin e fëmijëve, për ti emancipuar ata apo ato".

Me këtë rast, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i dha titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", si me poshtë: Zotit Edmond Tërthorja, Zotit Ndoc Vata, Zonjës Rovena Çuni, Zonjës Lena Ndrevataj, Zonjës Zoga Troja, Zonjës Drande Fiku Papeleka, Zonjës File Moshqeti, Zonjës Nusha Laçaj Gjeta, Zonjës Irena Fierza dhe Zonjës Lirjana Rama Çardaku.

Gjithashtu, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i dha titullin "Mirënjohja Martin Camaj", poetes Erenestina Gjergji Halili dhe poetit e shkrimtarit Anton (Ndoc) Papeleka.

Së pesti, me datën 15 qershor 2020, morën pjesë në ceremoninë përkujtimore të rënëve në muajin korrik 1915, në kuadrin e 105 vjetorit të kësaj Qëndrese, në Qeresh, N/kryetari Agron Hasanaj, anëtarja e kryesisë Klodjana Serraj, të cilët vendosen kurore pranë lapidarit, kushtuar kësaj ngjarje, dhe anëtari themelues i Shoqatës, Prele Shytani, i cili përshëndeti në emër të Shoqatës.

Së gjashti, me datën 16 qershor 2020, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me rastin e 105 vjetorit të rënies së atdhetarit Mehmet Shpendi, pranë monumentit të tij, në sheshin e zonës Industriale, organizoj një ceremoni përkujtimore. Në këtë ceremoni morën pjesë anëtar të SHAD, banore të Dukagjinit, të qytetit Shkodër dhe familjare të familjes së Mehmet (Sokol) Shpendi, historiani Dom Nike Ukgjini, në baze të mundësive që na krijoi pandemia.

Në përgatitjen e realizmin e këtyre veprimtarive kemi pasur mbështetjen e bibliotekës "Marin Barleti", të Drejtorisë së Policisë Shkodër, të institucionit të Prefekturës, Këshillit të Qarkut dhe e Bashkisë



Shkodër, të Njësive Administrative Shale, Shosh, Pult e Shllak, të cilët i falënderojmë dhe besojmë se edhe në të ardhmen nuk do të na mungojë bashkëpunimi në mes nesh. Gjithashtu kemi pasur mbështjen e biznesit dukagjinas në Shkodër, si: Bar-restorant “Orlando”, “Floga”, “Tradita”, “Elita”, “Miçigani”, “Blini” dhe “Scutari”, të cilët i falënderojmë dhe ju premtojmë, që nëpërmjet gazetës “Dukagjini” dhe veprimtarive të ndryshme, do të vijojmë më mirë e më shumë se deri më sot, të bëjmë publikimin e biznesit tuaj

Gjithashtu na kane mbështetur: Kujtim Funiçi, me banim ne SHBA, Anton Kosteri, Agim Gila (Martini), Ndue Nika, Gjergj Leqezja, Zef Nika, Luigj Temali, Agron Hasanaj, Klodjana Serraj, Gjergj Guri, ne Bruksel, Pjeter Gera, Motra Dukate, Sokol Strebçiqi, në Kanada, Preke Gjonaj, ne Kanada, Bar-Restorant “ELITA”, Nikolin Gjeshi, në Itali dhe Fran Shytani, me një shumë të përgjithshme **328 600 leke**. Prej tyre, 246 000 leke janë harxhuar për botimin e gazetës “Dukagjini”. (12 numra x 20 500 leke numri = 246 000 leke). Shuma prej 82 600 leke është shpenzuar për realizimin e veprimtarive



që janë zhvilluar.

Të gjithë i falënderojmë, që nga financa e tyre, kane kursyer për të mbështetur Shoqatën financiarisht, në punën për të realizuar misionin e saj. Besojmë, që kontributi i tyre, por dhe të tjerëve nën shembullin e këtyre, të kursejnë diçka në interes të punës së shoqatës, për të realizuar misionin e saj edhe në të ardhmen, gjate vitit 2021.

Për vitin 2021, Kryesia e Shoqatës, nuk ka bere ndonjë plan perspektiv për vitin 2021, për efekt të situatës, por ka vendosur, që të vijojë pa u ndalur për botimi i gazetës “Dukagjini”, në çdo muaj. Ajo, edhe për vitin 2021 ka të njëjtën kosto, prej 246 000 leke dhe besojmë se nuk do na mungojnë mbështetësit financiar edhe në të ardhmen.

Pra, për të vijuar punën Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në realizimin e misionit të saj dhe gjate vitit 2021, duhet kontributi i të gjithëve.

Së pari, kontributi intelektualëve dukagjinas, me ide e pjesëmarrje të tyre.

Së dyti, kontributi i biznesmenëve dukagjinas, se pa kontributin e tyre financiar nuk mund të përgatitën e realizohen këto veprimtari.

Besojmë në kontributin tuaj!

NDUE SANAJ,
Kryetari i shoqatës atdhetare
“Dukagjini”

KIRI - HISTORIA, NJERZIT DHE BUKURITË E NATYRËS

Doli në qarkullim libri “KIRI”, me autore Prele e Mri Kroj, pas një pune dhe përkushtim disavjeçar

Prele Kroj aktiviste e kontribuues i shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe i nderuar me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

Mri Kroj, anëtare themeluese e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe e nderuar me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”.

Ata te dy kanë punuar për shumë vite në Kir dhe me banorët e Kirit

Në faqen e para të librit kanë shkruar, se ketë libër ja kushtojmë :

*Le të mbetet ky libër simbol i dashurisë, respektit, vlerësimit dhe kujtimit për bashkëfshatarët tanë, të cilët tërë jetën e tyre iu përkushtuan punës së ndershme për të mbijetuar në çdo kohë pavarësisht vështirësive gjeografike, të vendit të jetesës, të klimës, të regjimeve të çdo lloji dhe mbeten të nderuar.

*Le të mbetet ky libër simbol i dashurisë dhe respektit për gjithë banorët e fshatit Kir (kiçorët) kudo ndodhen, që kurdoherë ditën me mençuri, me përkushtim e dashuri për vendin e tyre; të ruajnë familjen, nderin dhe emrin e të parëve. të tyre.

*Le të mbetet ky libër simbol i dashurisë, respektit, vlerësimit dhe kujtimit për gjithë pjesëtarët e familjes tonë, të familjes Kroj, kudo ndodhur, që nëpërmjet këtij libri të kujtojnë me respekt e të mos harrojnë gjakun e tyre.

Libri ka këto kapituj: Kemi bërë përpjekje të ndalemi e të shkruajmë sipas këtyre kapitujve apo çështjeve: - Prejardhja e fjalës “Kiri”, - Shtrirja gjeografike, - Formimi i fshatit, - Fiset dhe vëllezërit, që përbëjnë fshatin e Kirit, - Toponimet (Vendbanimet e Objektet e terrenit), - Disa vlera tradicionale, - Organizimi dhe drejtimi i fshatit, - Lëvizja e banorëve të fshatit, - Ngjarje të veçanta, - Figura e persona të përmendur, - Kiri vendi im (Publicistika e Prele Kroj), - Prelë Kroj

(Jeta e Prele Krojt), - Mbyllja (Disa porosi për brezat e tashëm dhe të ardhshëm)

*Falënderojmë për kontributin e dhënë në daljen e librit “KIRI”: Prof Tahir Bezhani, Gentian Fran Qarri, Mhill Kole Shkëmbi, Dede Nike Sokoli, Zef Pëllumb Teli, Ndok Gjesh Leka, Sokol Preke Cubi, Pëllumb Zef Odri, Lulash Gjon Prroj, Pëllumb Gjon Ndou, Gjon Mhill Ndou, Pëllumb Luc Dardha, Ndue Marash Maraçaj, Prele Dede Shkambaj, Gjin Kole Dermani, Mhill Mark Lari, Gjon Preke Kiri, Zef Tome Lulashi, Ndue Mark Kasneci dhe Pëllumb Prendash Hili e të tjerë, që na dhanë të dhënat e nevojshme për ketë libër!

*Falënderojmë konsulentët z Ndue Sanaj e Lulash Brigja për ndihmën, që na dhanë për përgatitjen e këtij libri dhe botimin e tij!

*Falënderojmë ata, që na mundësuan për botimin e librit: Vajzën, Mirela Vushaj, me familje; djalin, Gjonin, me familje dhe djemtë, Ndue e Nikolin Kroj!

*Falënderojmë shtëpinë botuese “FIORENTIA” Shkodër, për punën e bere në botimin me cilësi të librit!

Tani libri është në

dorën e lexuesve.

Dy opinione të shkurtra:

Studiuesi Luigj Shyti, thekson: “Urime e suksese në gjithë punën dhe jetën e autorëve, çifti Kroj, dhe gjithë atyre që kanë kontribuar në botimin e këtij libri. Është një shembull shumë i mirë, interesant dhe model për të gjithë ata që merren me hulumtime e botime te kësaj natyre. Ky libër ka një veçori mjaft interesante e domethënëse, bashkautorësia i një çifti, në mbledhjen e materialit, sistemimin dhe botimin e tij”.

Ndue Sanaj, shkruan: “Autorët, Prelë e Mri Kroj, përmes një kërkimi këmbëngulës dhe profesional, kanë bërë një udhëtim jo të lehtë në historinë dhe në gojëdhënat e fshatit të tyre, Kirin, me disa fise, të cilët mbijetuan në historinë e mjafttrazuar, duke ruajtur vlerat më të mira të trashëguara, si gjuhën, besimin, traditat, kulturën e jetesës, të gjitha ato vlera të shenjta shqiptare, që u krijuan në thellësi të shekujve dhe u bartën brez pas brezi. Duke dëshmuar historinë dhe gojëdhënat që lidhen me ketë fshat, libri pasuron kujtesën e kiçorëve, komunikon me vetëdijen e tyre, i bën ata të ndjehen krenarë, jo vetëm për vendin ku u lindën, por edhe për stërgjyshërit e tyre të lashtë, për njerëzit guximtare, mendjemprehtë e zemërmëdhën, që banuan në këtë fshat me shekuj e deri në ditët e sotme. Pikërisht edhe për këto, ky libër është një pasuri jo vetëm për kiçoret, bijtë e bijat e këtij fshati, por edhe për të gjithë ata që janë të interesuar të dinë, se si janë krijuar fiset dhe fshatrat shqiptare në mesjetën e hershme dhe se si ia dolën ta mbijetojnë historinë tonë dramatike deri në ditët e sotme”.

Përgatiti **Lulash Brigja**



KRONIKË SPORTIVE

Vllazni e frikshme, kryesimi i kampionatit dhe kualifikimi në çerekfinalet e Kupës, paralajmërim serioz për titullin e trofeve të vitit

Nëse për dikë, fitoret e Vllaznisë në javët e para të kampionatit ishin surprizë, dhe se në vazhdim ajo do të zbehej në lojën e saj për të zbritur në pozitën e mbijetesës, aty ku në fakt ka qëndruar gjatë të gjithë këtyre viteve, realiteti tregoi të kundërtën. Fitoret me Tiranën Brenda në “Loro Boriçi”, barazimi në transfertën e Durrësit me Teutën, fitorja e thellë 0 me 3 në transfertë me Kastriotin, dhe sidomos kjo e fundit me Partizanin sërishmi në stadiumin “Loro Boriçi” me rezultatin 1 me 0, e kanë ndryshuar tërësisht imazhin e kësaj skuadre. Aq sa, në sportiv, specialistët e futbollit dhe analistët sportivë po e konsiderojnë me të drejtë një “Vllazni të frikshme”, e cila është e pamëshirshme ndaj çdo kundërshtari që i del përpara, duke mos e kursyer ti mundë, brenda dhe jashtë fushës së saj. Fitoret e njëpasnjëshme dhe kryesimi i kampionatit me tre pikë më shumë se kundërshtari më i afërt, Kukësi, është padyshim një paralajmërim serioz për fitimin e titullit të 10-të kampion nga ana e skuadra kuqeblu. Me këto rezultate që ka regjistruar në këtë fillim sezoni, kryesuese e tabelës së klasikimit në kampionat, si dhe kualifikimi në çerekfinalet e Kupës së Shqipërisë, tashmë, pa as më të voglin dyshim duhet thënë se kjo është Vllaznia që duan tifozët shkodranë. Meritë kjo e padiskutueshme e vetë futbollistëve që janë protagonist në fushën e lojës, stafit teknik me në krye trajnerin, kroato-gjermanin Thomas Brdariç, drejtuesit e klubit dhe padyshim sponsorin Alban Xhaferi, i cili që pas nënshkrimit të marrëveshjes me Bashkinë Shkodër për mbështetjen e Vllaznisë, ka arritur të mirëmenaxhojë situatën në klubin kuqeblu, për të cilën flasin edhe vetë rezultatet e arritura deri më tani.



Vllaznia, festa e golit të shënuar ndaj Partizanit nga Dilaver

Vllaznia drejt privatizimit, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak për shitjen 100 % të KF Vllaznia, pritet ankand për shitjen e aksioneve

Këshilltarët vendor të Shkodrës, të cilët njëkohësisht janë edhe antarë të Asamblesë së KF Vllaznia kanë votuar pro propozimit të ardhur nga Bashkia Shkodër në lidhje me hapjen e procedurave të privatizimit 100 përqind të KF Vllaznia. Vendimi në fjalë, që konsiderohet shumë i rëndësishëm për fatet e së ardhës së futbollit shkodran, është marrë gjatë mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Shkodër, e cila falë situatës së pandemisë është zhvilluar online.

“Pr/ Vendim “Për dhënien e pëlqimit për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a. në masën 100%.”, -thuhej konkretisht në piken ku kishte të bënte me çështjen e privatizimit të Vllaznisë, e cila mori jo pak diskutime në radhët e këshilltarëve. Fillimisht, ishte kryebashkiakja Voltana Ademi që njëherazi mban edhe postin e presidentes të KF Vllaznia, e cila bëri një pasqyrë të situatës aktuale lidhur me përgatitjen e dokumentacionit që grupi i punës ka dorëzuar në Këshillin Bashkiak. Për hirë të së vertetës duhet thënë se ashtu siç e kanë bërë të ditur edhe në prononcimet e mëparshme, përfshirë edhe vetë kreun e Këshillit Bashkiak, Brisela Kadija, këshilltarët kanë shprehur vullnetin e mirë për ta çuar Vllazninë drejt procesit të privatizimit, por nga sa u pa, në pyetjet dhe diskutimet e tyre, ato kërkonin zbatimin e këtij procesi me baza sa më ligjore, në mënyrë që mos të ketë probleme në vazhdimësi lidhur me këtë temë, pasi më herët kanë pasur një përvojë shumë negative me një kompani zviceriane, me të cilën janë akoma në process gjyqësor.

Në fund, ka ardhur edhe votimi, ku me 39 vota PRO, projektvendimi në fjalë “Për dhënien e pëlqimit për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a. në masën 100%.”, është miratuar nga këshilltarët vendorë. Miratimi i kësaj pike konsiderohet shumë i rëndësishëm dhe si momenti më pozitiv për fatet e futbollit shkodran në vazhdimësi, duke i hapur rrugë një menaxhimi krejt tjetër në duart e privatit, dhe duke e shkëputur njëherë e mirë administrimin nga institucioni vendor, që për hirë të së vertetës ka konsumuar shuma të mëdha financiare në kurriz të taksapagueve shkodranë për të mbajtur klubin në këmbë.

Pas këtij vendimi të Këshillit Bashkiak Shkodër, strukturat përkatëse në Bashkinë Shkodër kanë vijuar punën për procedurën e nxjerrjes në ankand të aksioneve të KF Vllaznia, ku shuma e miratuar me këtë rast si çmim fillestar është prej rreth 600 milion lekësh të vjetër.

Pas këtij vendimi, nuk kanë vonuar të dalin në skenë të interesuarit për blerjen e aksioneve të KF Vllaznia. Ndër to, duhet spikat ish presidenti i Vllaznisë Valter Fushaj, i cili përmes një konference shtypi organizuar në mjediset e Hotel Colosseot, pjesë e kompanisë që ai administron, bëri të ditur gatishmërinë e tij për blerjen e aksioneve të Vllaznisë, madje deri në kuotën e 70 % të këtyre aksioneve. Nga sa ka bërë të ditur më herët, pjesë e interesimit për blerjen e aksioneve të Vllaznisë është edhe sponsori aktual i kuqeblove, Alban Xhaferi. Ndërkohë, gjithnjë nga informacionet e marra rreth kësaj çështje, por e konfirmuar edhe nga vetë zoti Fushaj, pjesë e blerjes së aksioneve pritet të jenë edhe kolegët e tij en vite, si ish presidenti tjetër Agron Çela, ish zv.presidenti Xhevdet Amuli, sponsori Flamur Hoxha, etj.

6 vite pa Mejdan Zhivanin, koleg i dashur na mungon shumë!

Për komunitetin mediatik të Shkodrës dhe më gjërë, dhjetori është një muaj që e lidhë me kujtesën ndaj ish kolegut të tyre, Mejdan Zhivani. Lajmi shumë i hidhur i mes 6 vite më parë, për ndarjen nga jeta përpara kohe në moshën 38 vjeçare, të gazetarit dhe komentatorit të mirënjohur sportiv, Mejdan Zhivani ishte sa prekës dhe tronditës, jo vetëm për kolegët e tij, por edhe për gjithë opinionin sportiv, i cili ka qënë shumë i lidhur me ushqimin e informacionit sportiv që përcillte Mejdani në publik.

Megjithë interesimin, mbështetjen dhe përkujdesjen maksimale të familjes “Zhivani”, por edhe të familjes së madhe mediatike dhe asaj sportive që nuk kurseu asgjë për shërimin e tij, një sëmundje e rëndë që e mudoi për muaj të tërë, nuk i dha mundësi të jetonte. E ndau nga familja, bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij të vegjël, në kujtesën e të cilëve do të mbetet përherë imazhi i prindit dhe familjarit shembullor. Dhe, në të njëjtën kohë e ndau nga pasioni dhe aktiviteti i gjithëanshëm mediatik, lokal dhe kombëtar që me aq shumë përkushtim i shërbente.

Iku shumë herët fizikisht, në kulmin e karrierës së tij si gazetar sportiv, komentator dhe drejtues i emisioneve sportive, por kujtimet e shumta që la me kolegët e tij, sidomos me ne të Shkodrës, bëjnë që ai të jetë vazhdimisht mes nesh, ashtu i qeshur dhe i pastër në shpirt, simbol i korrektesisë dhe profesionalizmit, veti që e karakterizonin si askend atë.

Mejdan Zhivani, ishte një nga emrat e njohur, kryesisht pas vitit 2000, ku krahas qytetit të Shkodrës ku pati fillimet dhe angazhimin kryesor në mediat lokale, si Radio Shkodra, televizionet “TV1 Channel” dhe TV Rozafa”, gazeta “Vllaznimi Sportiv” etj, u angazhua më pas në shtypin qëndror, ku punoi vitet e fundit, si në gazetën “Sporti Shqiptar” dhe së fundmi në Radio-Televizionin Shqiptar. Emri i tij është i pazëvendësueshem, por ndërkohë, padyshim që është kënaqësi e veçantë kur traditën e familjes “Zhivani” në fushën mediatike po e vazhdon në mënyrën më të mirë nipi i tij, Klodian Zhivani, korespondenti i Top Channel në Shkodër, si dhe i TV1 Channel në qytetin e verior, një arsye më shumë për ta pasur në kujtesë të përhershme të paharruarin Mejdan!

Me kujtesën, nderimin dhe respektin për këtë figurë të medias sportive, që sot nuk jeton, bashkohet edhe redaksia e gazetës “Dukagjini”.

Pushofsh në paqe koleg i nderuar!

Përgatiti faqen Gaspër Marku



PREKË ULI GJOKAJ NJË JETË NË SHËRBIM TË ATDHEUT



Prof. Gjon Frani Ivezaj

Në burimet e hershme historike dhe dokumentet arkivore ku historian e kronikanë vendas dhe të huaj apo personalitete të jetës politike e shoqërore si studiues, albanologë e shkrimtarë, thuhet se Gruda ishte një qendër shumë e rëndësishme e Shkodrës antike. Gruda si fis përmendet që nga fillimi i shekullit XIV dhe ka prejardhje ilire, kjo e vërtetuar dhe e argumentuar edhe nga historianët dhe studiuesit shqiptarë e të huaj. Në burimet e shkruara me këtë fis njihemi përmes veprës dhe shkrimeve të misionarit të madh Italian Atë Domeniko Pazi (1847-1919) i cili flet për të parin e fisit Vuksan Gel Gjon Gruda. Sipas tij, fisi i Grudës, është i ardhur nga Basumët e Postribës të Shqipërisë së Veriut (Shkodër), të cilët në shekujt XV-XVI u vendosën në malin e Grudës së sotme kreshike, për të shkruar një histori të lavdishme përmes grykës së pushkës e për të ba emer të madh në malësi e më gjërë. Bijtë e Vuksan Gelës, punuan dhe ndërtnuan shtëpitë e tyre në formë kulle me frëngji në malin e Grudes. Falë aftësive dhe mençurisë së tij i pari i vendit (krahinës) u bë atdhetari i shquar Vuksan Gela i Grudës. Gruda si fis në fund të shekullit XV përfshihej në nahijen e Zhablakut dhe kishte 80 shtëpi. Ndërkaq emërtimin në vete Nahija e Grudës, e ka marrë në vitin 1485, kurse më 1497 nuk përmendet në defterët osmane si nahije. Simbas burimeve historike, kisha e Grudës, ka një histori legjendare ndër shekuj. Kjo vërtetohet edhe fjalët e kryepeshkëvit të Tivarit imzot Vinçenc Zmajeviku tek libri Kuvendi i Arberit 1703, fq. 35, botim i shtepise botuese "Shpresa" Prishtinë 2003. Ai përshkruan se në Dinoshën e Grudës përveç ndertimeve të hershme urbane që njiheshin si qytetza, ekzistonte kisha e shën Mhillit, themelet e të cilës i përkasin shekullit V. Edhe studiuesi dhe albanologu italian Ermanno Armao, duke u bazuar në një hartë të lashtë (të dy hartografëve të shekullit XVII), shkruan: "... Kemi të bëjmë me kishën e lashtë të fisit të Grudës kushtuar shën Martinit ipeshkëv, e ndërtnuar nga Eterit Françeskanë me 1646 dhe që ishte dirocata, (shënim i përkthyesit), në vitin 1671 kur atë Gaspari

ishte në kalim." Kisha e rindërtuar më vonë me një mjeshtri të mrekullueshme, gjendet në një vend të veçuar në bregun e djathtë të lumit të Cemit, në katundin Priften, qendër e katolikëve të Fisit, 320 metra mbi nivelin e detit. Po ashtu në një vizitë baritore të ipeshkëvit të Shkodrës Pal Kamsi në vitin 1756, përshkruan se Gruda kishte 106 shtëpi me 744 banorë të rritur, me 200 luftëtarë të pushkës, 68 fëmijë të krezmuar atë vit 17 femra e 18 mashkuj dhe 6 martesa. Ndërsa një relacion tjetër mbi misionet e Shkodrës i datës 13 gusht 1758, shkruar prej prefektit apostolik at Michelangelo da Taranto, nënvizon faktin se në Grudë, është rritë numri i katolikëve, që martohen, simbas rritit të kishës së shenjtë. Të gjitha trevat arbërore rane në sundimin e plotë të mizorisë së osmanëve dhe sllave të pa shpirtë, të cilat, kaluan një kalvar të pashembullt krimesh dhe masakrash antinjerëzore për shekuj me radhë, duke u munduar ti shuajnë shqiptarët, gjuhën, fenë, zakonet, dhe traditat e tyre, pra tu sllavizojë çdo gjë të identitetit të pastër shqiptarë. Burimet e hershme historike tregojnë letrat e kryepeshkëvit të madh imzot Pjetër Bogdani, të datës 28 gusht 1670, ku përshkruan vuajtjet e torturat e besimtarve katolik të Malësisë e të Shkodrës, në të cilën ai i lutet Kongregatës së Shenjtë, që të caktohen dy misionar të Eterve të Reformuar; njërin në Rrjoll e tjetrin në Grudë. Mali, Bajraku apo Fisi i Grudës, ka qenë vazhdimisht edhe në vëmendjen e shumë studiuesve dhe albanologe të huaj, të cilët Grudën e shohim si njerin ndër gjashtë kuvendet kishtarë, që bënë pjesë në Prefekturën Apostolike të Kastratit me 1500 banorë katolik në vitin 1850. Për shumë dekada kisha e famullia e Grudës njihet nën emrin e shën Martinit ilir shën Martinin. Në historinë e kishës, shkruhet se shën Martinin kishte lindur nga prindër ilir, ku babai i tij kishte qënë oficer në ushtrinë romake, dhe në fillim vetë shën Martinin kishte marrë pjesë si ushtar (kalorës), por pa vonuar u ishte kushtuar rregullave kishtarë dhe në vitin 370 zgjidhet ipeshkëv i Toursit në Francë. Predikimet dhe kontributi në jetën meshtarë e ungjilltare të shën Martinin qënë aq të mëdha në Francë sa kishin sjellur mrekulli, të cilat u njohën edhe nga vetë kisha kristiane. Francezët e vlerësuan dhe besuan aq shumë shën Martinin, sa kur u nda nga jeta toksore me 11 nëntor të vitit 397 e mbrapa i kushtuan rreth 3600 kisha famulltare, si dhe me emrin e tij u identifikuan 240 fshatra e qytete. Mbretërit Francës e njohën edhe si Patron të tyre. Në atë hohë françeskanët prej Grude ushtrojnë sherbime fetare në Hot, Triesh, Kojë dhe kudo në Malsi të Madhe. Prej vitit 1638 deri në vitin 1903. Aty kanë shërbyer 46 misionar Kroat e italian. Që

nga viti 1903 e sot kanë shërbyer kryesisht meshtarë shqiptarë. Duhet theksuar se gjatë tallazeve të historisë, kisha e Grudës u djeg nga ushtria barbare sllave (malazeze) dhe turke, që sulmoi Malësinë, e cila me heroizëm të pasohq i rezistoi me stoizëm dhe armë në dorë, duke mos iu nenshtruar pushtuesve mizorë. Simbas, atë Anton Harapi O.F.M, i cili bën një përshkrim brilant për këto troje, ndër të tjera thotë: "Me heroizëm të madh, malësorët e Grudës i ruajtën gjithnjë shtëpinë e zotit dhe trojet e veta. Gruda, në mesin e këtyre ngjarjeve të stuhishme historike, luftimeve dhe përpjekjeve për liri e pavarësi, u bë qendra e të gjithë luftarve dhe rezistencës me armë në duar, duke treguar gjithmonë heroizëm dhe përkushtim të madh, e ideale të trashiguera për mbrojtjen e tokave, fenë dhe Atdheut e të parëve të tyre. Malësorët e Grudës, historikisht u bënë ballë të gjitha sulmeve pushtuese barbare, si turqve, sllavëve etj., që kishin për qëllim pushtimin, nënshtrimin dhe asimilimin e trojeve tona stërgjyshore ndër shekuj dhe historikisht dihet se trimat e paharruar të Grudës ishin patriotët: Vuksan Gela, Smajl Martini Ivezaj, Nikë Martini Ivezaj, Dedë Nika Ivezaj, Mat Hasani Ivezaj, Zef Martini Ivezaj, Zef Prel Marashi Ivezaj, Prel Marashi Ivezaj, Smak Deda Ivezaj, Kolë Zefi Ivezaj, Bacë Vuksani Ivezaj, Preç Vuksani Ivezaj, Vuksan Preçi Ivezaj, Sokol Baci Ivezaj, Tringë Smajlja Ivezaj, Mehmet Murati Gjokaj, Baca Kurti Gjokaj, Zef Miliqi Lulgjuraj,



Dodë Prekë Uli, (Micaj) Gjokaj

Gjekë Gjoni Sinishtaj, Ujkë Mati Ivezaj, Lucë Gjeloshi Lulgjuraj, Mark Gjeku Lulgjuraj, Kolë Marku Lulgjuraj, Maxha Grishi Bojaj, Mirash Luli Bojaj, Palokë Gjoka Vulaj, Ujkë Dushi Kalaj, Tomë Kolë Gjoni Sinishtaj, Pllum Gjeka Ka-

laj, Prekë Gjon Ruka Ivezaj, Halil Haka Nikaj, Ali Zeku Pepaj, Marash Dashi Kalaj, Prëtash Leci Sinishtaj, Selman Juku Dukaj, Nikë Smaka Ivezaj, Pjetër Nika Ivezaj etj.,

Sikurse Gruda burra me nam e me za kanë pasë të gjitha Malet e Malësisë ndër ta përmendet edhe Ulë Marku me djalin e tij Prekë Ulin, që lanë nder dhe krenari në Grudë dhe Malësisë tonë legjendare. Për malësorin kreshnik dhe sypatrembur Prekë Uli Gjokaj, gjithnjë liria dhe mikpritja, sipas traditës së hershme shqiptare ishte dhe është sot gjëja më e shtrenjtë. Ai dhe brezat mbas tij vijuan të ecin në rrugën e traditës atdhetare dhe patriotike të të parëve të tyre. Malësia jonë, ndër shekuj është shquar për figura të ndritur, që kanë bërë emër të mirë në të gjithë krahinën, ku ato jetuan dhe vepruan, duke shkruar me armë në dorë histori të lavdishme për trojet etnike shqiptare. Për shkak të luftimeve të njëpasnjëshme, kundër serbo malazezëve dhe Perandorisë Islame Osmane, shumë malësorë të krishterë, u detyruan që të shpërngulen nga trojet e të parëve të tyre shumë shekullore e u vendosën në vende të ndryshme banimi, ku kishte vetëm shqiptarë. Kështu Ulë Marku Micakaj, u detyrua nga Bëkajt e Trieshit të Malësisë së Madhe të shpërngulet e të vendoset në Dinoshë të Grudës, në grykën e Malit Tojeq. Këtu malësori fisnik dhe trim Ulë Marku aty gjeti 20-30 shtëpi malësore të besimit islam. Sipas të dhënave, që janë transmeruar brez mbas brezi, mendohet se Ulë Marku ka ardhur në Dinoshë rreth vitit 1850. Vëllezërit muslimanë malësorë të zonës e deshtën dhe e nderuan gjithmonë bashkëatdhetarin e tij të fshatit të tyre. Ai aty gjeti ngrohtësi, mikpritje dhe bujari tradicionale shqiptare. Të gjithë malësorët, pa dallim feje luftonin kundër pushtuesve shumë shekullore otoman dhe serbomalazez, që kërkonin të nështronin dhe mposhtin popullin shqiptar. Ulë Marku në Tojeq të Dinoshës gjeti një shtëpi katolike e ardhur nga fisi Lucaj prej derës së katundit Delaj (Trieshit) me emrin Gjokë, e cila më vonë është islamizuar me dhunë nga pushtuesit turq. Ata sot quhen familja e Jusuf Gjokës. Shumë vite me vonë ata kanë lëvizur në zonat e banuara në Tojeq, Dinoshë, po ashtu nga Luhari ka ardhur një shtëpi katolike me mbiemrin Puraj, e cila edhe ajo është e islamizuar nga turqit me forcë. Në këtë mënyrë ka ardhur edhe një familje prej fisit Dukaj të Trieshit, e cila edhe ajo është islamizuar. Prej kësaj familje sot është shtëpia e Selman Jakut (Dukaj). Po këtë rrugë ka ndjekur edhe një familje prej fisit të Lulgjurajve të Grudës, të cilët edhe ato janë islamizuar, sikurse edhe të tjerët më parë. Pra, sikurse shihet këto

familje ndryshojnë vetëm emrat dhe asnjëherë mbiemrat, duke ruajtur kështu vijimsinë e e krishterë të rrënjëve të lashta të familjeve të tyre. vrs Kulla e Ulë Markut, ka qenë e mirënjohur ndër shekuj për urtësi, mikpritje, besë, atdashedashuri. Trimat e kullës, kanë qenë gjithnjë në ballë të luftrave për liri dhe pavarësi të trojeve etnike shqiptare. dabl sdb Në një mjedis të ri shqiptar Ulë Marku, filloi të punoj dhe jetoj paqësisht, mes vëllezërve muslimanë shqiptarë. Pas disa vitëve ai martohet dhe krijoi familjen e vet. Aty Ulë Markut i lindën dy djem dhe disa vajza. Djali i parë Gjoni lindi në vitin 1858, kurse djali i dytë Prekë Uli lindi në vitin 1860. Në të gjithë Malësinë e Madhe, kjo familje e re mes shqiptarëve të mirë gjithmonë ishte e nderuar dhe respek- ibi inituM tuar. Ata brez mbas brezi luftuan me pushkë në dorë kundër pushtuesve të njëpanjëshme, që prekën herë pas here tokat shqiptare. Ulë Marku 21 vjeç, ishte një djalë azgan e trim si zana, dhe mori pjesë në kryengritje anti osmane dhe kundër syn- imeve grabiqare të malazezëve. Ai ishte një punëtor i palodhur, ku me duart e tij të arta ndërtoi një kullë prej guri dy katëshe me frenxhi, që ngjante me një kështjellë ushtarake të kohës, për tu mbrojtur nga pushtuesit otoman e serbo malazezët. Uli, ishte një burrë i hijshëm, i gjatë si lisat e maleve tona, i zgjuar për nga natyra, i urtë ei matur në biseda me malësorët, fjalëpakë, njeri i besës, trim si zana, bujar në shpirt e me zemër, dhe si gjithmonë një derë e njohur për mikpritje shqiptare etj. Ai mori pjesë në shumë luftra liridashëse, që Malësia zhvilloi ndër shekuj, si në luftën e Dinoshës, Shkodrës, Grudës etj., kur në atë kohë Gruda udhëhiqej nga trimat legjendarë si trimi i famshëm Smajl Martini i Grudës. Në vitet 1880-1881 Ulë Marku ishte bashkuar me trimat e tjerë malësorë dhe kishte dalë në ballë të luftës së Dinoshës dhe Grudës kundër ushtrisë serbo malazeze. Aty për orë të tëra u bë një luftë e përgjakshme, ku shk- jetë humbën shumë ushtarë dhe armatime luftarake. Ud- hëheqësi dhe kryepirësi i malësorëve kreshnik ishte trimi legjendar Smajl Martini Ivezaj. Lufta zgjati deri në mbrëmje. Smajl Martini me djemtë e Grudës i dha ikjen ushtarëve malazeze. Në orët e vona të mbrëmjes Bajraktari i Grudës Smajl Martini urdhëroj luftëtarët e Grudës të gjithë të bashkohen, duke merrë me vete të vdekurit dhe të plagosurit rënde, për t'i derguar tek kisha e shën Mhillit në Dinoshë. Në atë luftë të përgjakshme u varros trimi i malëve Ule Marku vendin e quajtur në Shtigje, ku po zhvillohej lufta.

Ai ishte goditur nga plumbi i armikut, i cili i kishte thyer kembën. Ulë Marku, ishte shumë i lodhur. Ai ecte zvarrë nga plagët e përgjakura. Në gjysmë të rrugës ai u ndal për të pushuar se nuk mund të lëvizte më tej. Ulë Marku, për orë të tëra kishte derdhur shumë gjak. Ai u ndal në afërsi të një shkëmbi me pushkë në dorë. Ushtria e luftarëve malësorë të Grudës, duke u tërhequr poshtë aty gjen ushtarin trim Ulë Markun e plagosur shu- më

rëndë, i cili, po humbte gjak nga plaga e rëndë. Atij i afrohet trimi Murat Mehu Gjokaj prej Mileshtit. Murati, duke qene errësirë e pyet se çfarë po bën këtu. Ai i përgjigjet se jam plagosur (varrue), më ka ra pushka e më ka thy këmbën dhe s'mundem të lëviz. Trimi Ulë Marku, i thotë Murat Mehu: "Shko tek shokët, se unë kam pushkën dhe fishekë boll. Nëse kthehen shkjetë, unë e paguaj vetën." Trimi Murat Mehu i Gjokajve të Mileshtit, vinte nga një derë e madhe e mirënjohur në të gjithë krahinën Malësisë për pushkë dhe mikpritje. Murati, duke e parë gjendjen e rëndë të bashkëluftëtarit Ulë Markut, i cili, po vazhdonte të humbte shumë gjak, i thotë se nuk mund të ik dhe dua të qëndroj me ty këtu. Ai e merr në krah bashkëluftëtarin e tij të plagosur rëndë dhe me pushkë në dorë ngadalë e ngadalë e çon deri tek shtëpia e tij. Luftari dhe trimi si zana Murat Mehu, menjëherë kthe- het dhe shkon tek kisha e shën Mhillit, ku ishin bashkuar ushtria e malësorëve, të plagosurit dhe të vranët. Ai u tregon atyre për plagosjen e rëndë të trimit Ulë Markut. Bajraktari i Grudës Smajl Martini, menjëherë ngrihet në këmbë, e falënderon nga zemra trimin e varrosur Ulë Markun dhe burrërinë e trimërinë e Murat Mehut. Në mëngjez herët, bajraktari Smajl Martini së bashku me luftarin trim Murat Mehu dhe 12 luftarë të tjerë të Grudës shkon menjëherë në kullën e luftarit trim Ulë Markut. Bajraktari i Grudës, gjatë takimit e rifalënderon Ulin, për trimërimë në luftë dhe gjakun e derdhur për tokat shqiptare dhe liri, dhe i dëshiron jetë të gjatë dhe shërim të shpejtë. Nga burimet historike, mesojmë se prej kësaj dere ka lindur edhe djali i tij i famshëm Prekë Uli, i cili, ka treguar gjithmonë heroizëm të pashoq për çështjen kombëtare. Preka, merrte pjesë në luftrate me malësorë dhe Malësi, kundër armiqëve shekullorë serbo malazezëve dhe ushtrisë aziatike turke, për liri dhe pavarësi dhe ekzistencën e trojeve etnike shqiptare. Fjala e tij përhapet kudo në trojet etnike shqiptare deri në Kosovë. Duke hulumtuar me shume kujdes për këtë figurë të rëndësishme të historisë shqiptare, mesojmë se për Prekë Ulin nga Dinoshë, kemi mundur të gjejmë artikuj intere- sant, ku midis të tjerëve ka shkruar edhe pajtuesi i gjaqeve, simboli i paqes dhe mirësisë mes shqiptarëve Prof. Anton Çetta, ku ai ndër të tjera vlerëson: "Prekë Uli ishte symbol i bashkëjetesës vëllazërore mes kato- likëve e muslimanëve të Grudës. Ai për të mos koritur katundin, rrezikon jetën nga ushtarët malazez, të cilët një ditë tek e gjejne Prekën coban me dele se bashku me çobaneshen Bibe Kegja i thonë: "Prej kah je?"

Dhe Preka u përgjigjet prej Dinoshet. Malazezët e pyeten a je musliman apo katolik!? Jam katolik, u thotë Preka. Ushtarët, deshtën me e vertetu këtë gja e i thonë nëse je katolik ban kryq! Prekë Uli u thotë: "Nuk u duhet ju kjo gja, mem detyru mue me ba kryq!" Ata (malazezë) i thonë prap: "Ose ban kryq ose të vramë, mbasi ti nuk na ke kallzue të vertetën, se ndoshta nuk je katolik!"

Dhe tre ushtarët ia kthejnë pushkën. Çobaneshja Bibë Keqja i thotë: Ban kryq se të vranë, se ti përditë ban kryq disa herë. Por ai ia kthen le të më vrasin. Nuk baj kryq që të mos thonë se e bame një musliman me ba kryq (pasi në Dinoshë janë shumica muslimanë, me përjashtim të pak shtëpive katolike). Tre ushtarët malazezë e panë se nuk po mujshin me e detyrua me ba kryq ketë grudas, ndaj ulen armët e shkuan." (Anton Çetta, "Nga folklori ynë", Volumi III, Prishtinë, 1995, f. 151- 152). Prekë Uli, ishte pjesëtarë i kryengritjes së flamurit kuq e zi, në Malësi më 6 Prill 1911 në istikamin e Deçiqit. Kulla e Prekë Ulit është djegur dy herë në vitet 1918 dhe 1921 prej ushtrisë malazeze, sepse ishte një kullë leg- jendare me luftrarë trima. Në kohën e formimit të shtetit federal të Jugosllavisë, popullit shqiptar i digjnin shtëpitë, arrestoheshin njerëzit pa faj, vriteshin njerëzit pa pasur asnjë faj. Prekë Uli, mbajti mbiemrin Micakaj deri në vitin 1921 në Tojeq të Dinoshës. Kështu me 12 mars të vitit 1921 prej turturave të vështira, që i bëri ushtria malazeze mbi po- pullin shqiptar, u bashkuan ato shtëpia që kishin ardhur nga viset e tjera dhe bënë një mbledhje që të bashkohen të gjithë 6 a 7 shtëpitë dhe të formojnë një fis, të cilët më vonë fillojnë të quhen Gjokaj, simbas Gjokës, i cili, kishte ardhë i pari në këto vise në Tojeq të Dinoshës. Kështu u krijua fisi i ri Gjokaj, të cilët sot si shqiptarët muslimanë dhe katolikë e mbajnë këtë mbiemër me re- spekt. Kjo gjë u bë për me ra në sy të armiqëve, sepse ata janë një fis i madh etj. Prekë Uli, gjatë gjithë jetës së tij ka treguar heroizëm, nder dhe respekt, duke e nderuar dhe respektuar e gjithë Malësia, duke mbetur në analet e historisë sonë kombëtare. Dera e Prekë Uli Gjokaj, ka qenë e njohur historikisht edhe nga banorët e qytetit, si njerëz të pushkës, nderës, besës, trimërisë, odës së kuvendeve të burrave, lahutës e çiftelisë, në të cilën janë përjetuar gojë më gojë historitë e lavdishme të Hotit e Grudës, në luftë kundër pushtuesve shumëshekullorë turq. Atdhetari e luftëtar i njohur Prekë Uli Gjokaj, ishte një derë e fortë dhe me zë në të gjithë trevën në fjalë. Ai shquhej edhe bujari dhe mikpritje ndaj miqve dhe kalimtarëve të ndryshëm vendas dhe të huaj. Aty gjetën menjëherë ngrohtësi e bujari tradicionale malësore, besë dhe bujari, ndihmë dhe integritet të shpejtë në ambientin e ri, ku u vendosën këto miq te rinj të Grudës. Me pushtimin e trojeve tona në vitin 1571, simbas kronikave historike, pothuajse të gjithë barqet (breznitë) e Malësisë së Veriut, bënë lëvizje (migrime), nëpër shumë vende gjatë kohës, kur qyteti verior Shkodra po kalonte çastet e hidhura nga mësymjet e të huajve. Shqiptarët dhe në veçanti malësorët e Grudës, rrokën përherë pushkën në mbrojtje të trojeve të tyre stërgjyshore, duke qenë një pengesë serioze për pushtuesit turq. Shpesh familjet e tyre shtoheshin me djem, që sipas konceptit të malësorëve do të thoshte asokohe se kishte më te- për pushkë, për t'i bërë ballë pushtuesve osmanllinj, që

në Malësi gjithnjë gjetën kundërshtimin më të ashpër me armë në dorë, pakënaqsinë dhe ndjenjën e lartë të kundërshtimit dhe mosnënshtimit ndaj zgjedhës së huaj. Ndër shekuj, për malësorin gjithnjë liria ishte gjëja më e shtrenjtë. Krenaria e malësorëve mbijetoi ndër shekuj. Kjo mirë- njohje u njoh gjithnjë me fisnikëri nga prijësi i parë i Grudës Vuksan Gela me katër djemtë e tij. Patriotizmi i madh i treguar me shembuj konkret nga Vuksan Gela i Grudës dhe sokolat trima e fiseve të tjera, u shpreh tek mbrotja me vendosmëri, që ata i bënë atdheut e fesë së të parëve të tyre, ndër shekuj, në mënyrë që kishat tona shqiptare të mos kthehen në minare të xhamive turke. Prej derës Micakajve (të Trieshit), sot Gjokajt e Tojeqit (Grudës), gjatë shekujve kanë dalur burra me zë në të gjithë trevën e jashtë saj, të cilët tradicionalisht janë shquar për vrytytet e hershme shqiptare, si: besa, trimëria, atdheda- shuria, zbatimi me përpikmëria i kanunit, urtia, oda e bur- rave, mikpritja me zemër dhe bujari, për të gjithë miqtë dhe kalimtarët e thjeshtë, që kanë bujtur në këtë kullë fisnike plot njerëz të ndershëm e bujar. Malësorët trima dhe fisnik Ulë Marku, e Prekë Uli, ishin uhe mbetën figura të mëdha të kombit shqiptar, të cilët, BA tne jetën e tyre luftuan me armë në dorë në mbrojtje të trojeve etnike shqiptare. Ulë Marku, iu bashkëngjit patriotëve të shquar, që aso kohe vepronin në qytetin e lashtë të Shkodrës dhe trevave të Malësisë së Madhe. Ulë Marku, gëzonte respekt në të gjithë vendet ku ai shkonte, sepse kishte besë, burrëri, trimëri, bujari, ndërsh- mëri, ishte njeri i fjalës, nderit, respektonte kanunin e maleve tona kreshnike, ishte njeri i urtë dhe shumë i mençur në zgjidhjen e probleme të trevës së tij, luftoi pa resh- tur për ndërgjegjësimin e malësorëve për liri dhe pavarësi kundër Portës së Lartë të Perandorisë Islame Osmane. Gjakderdhja, ishte dhe mbeti një plagë, që e ndihmoi edhe më shumë pushtuesin turk të jetonte më gjatë në tro- jet tona, sepse malësorët dhe në tërësi shumë krahina shqiptare, në vend që të luftonin turkun ia kishin drejtuar grykën e armëve shtëpive në hasmeri. Ulë Marku, ishte bashkëkohës i trimit legjendar Smajl Martinit, që ishte Bajraktari i Grudës, i Çun Mulës të Hotit, Pec Petanit të Shkrelit e të Keç Turkut të Kelmendit etj. Ai me armën ngjeshur mori pjesë në luftrat më të përg- jakshme të popullit shqiptar, në kryengritjet e njëpasnjë- shme që u zhvilluan në Malësi, të tilla si: Lufta e Spushit, kundër taborreve mizore turke, u dallua si një luan i vërtetë në Betejën e Deçiqit në vitin 1890, në Luftën e Plavës dhe Gucisë etj. Shtëpia e njohur e Prekë Uli Gjokajt të Tojeqit (Triesh), Grudës nxori burra me famë, zë dhe besë, nderë, fjalë, trima e azganë, që me shembullin personal shkruan histo- rinë e krahinës përmes flakës së barutit të pushkëve të tyre, duke qenë përherë ndera dhe krenaria e përhershme për Malësi dhe trojet etnike shqiptare.

Dokumenti i Stefano Gasparit i vitit 1671, historiku i shkruarjes dhe i publikimit të tij. Mark Palnikaj sjell për lexuesit “Relacione për Gjendjen e Shqipërisë në Shekullin XVII-XVIII”

Nga Mark Palnikaj

Dokumenti i Stefano Gasparit (Shtjefën Gaspri) i vitit 1671 konsiderohet si më i rëndësishmi për Historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. Në të gjitha rastet kur është komentuar është cilësuar si “Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1671”. Në të vërtetë nuk është një relacion në kuptimin zyrtar të tij.

Pas krijimit në Vatikan, në vitin 1622, të institucionit për përhapjen e fesë e quajtur Propaganda Fede, njëri nga vendimet ka qënë detyrimi për klerikët që punonin brenda kontinentit Europian të dërgonin çdo vit nga një relacion për gjendjen në teritorin që ata administrojnë nga ana fetare. Ata që punonin në vende të tjera jashtë Europës, duhej detyrimisht të dërgonin një relacion së paku një herë në dy vjet.

Relacioni nuk mund të hartohej sipas dëshirës së njërit apo tjetrit klerik, por ishte formuluar një listë me 27 kërkesa, mbi të cilat duhej të dërgoheshin të dhëna. Në vitin 1802 numri i pikave, mbi të cilat duhej të përfshiheshin të dhëna në relacionet e dërguara, ishte 69.

Ky raport i Gasparit është kërkuar me vendosmëri nga Papa dhe është sponsorizuar me fond të veçantë nga Kisha, ndryshe nga relacionet që ishin një detyrim ligjor dhe një punë rutinë që duhej të kryhej nga Ipeshkvijtë, Vikarët Apostolikë dhe meshtarët në zonat ku ata shërbenin.

I shkruar në 125 fletë dhe i shpërndarë në 211 faqe dorëshkrim, ai i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ dhe ka rëndësinë e një studimi të plotë për zonat që autori i studjoi dhe i shkeli me këmbë për dymbëdhjetë muaj pa ndërprerje.

Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se ai provon që popullsia e Arbërisë e përfshirë në teritorin e shtatë dioqezave, në shumicën dërmuese i kishte mbijetuar asimilimit fetar dhe nuk kishte pranuar të bëhej renegat i fesë katolike në një pjesë të madhe të sajë. Këtë qëndresë e kishin bërë në mënyrë të pavarur dhe pa mbështetje nga Selia e Shenjtë për afër një shekull e gjysmë.

Në masë të madhe ata jetonin si arbër, por si të krishterë jetonin vetëm për forcë zakoni dhe jo sepse kisha romane kishte treguar ndonjë përkujdesje për ta. Selia e Shenjtë nuk kishte hequr dorë zyrtarisht nga përkujdesja për këtë popullsi, por për shkak të dhunës së jashtëzakonshme që ushtronin pushtuesit turq në zonat e pushuara prej tyre, ushtrimi i fesë së krishterë përbente një rrezik shumë të madh për klerikët. Prandaj edhe besimi i krishterë ishte dobësuar shumë në këto zona.

Dokumenti i Gasparit përmban të dhëna të hollësishme për numrin e popullsisë,



por edhe për vendbanimet dhe emërtimin e tyre edhe kur janë katër apo pesë familje. Ka të dhëna gjeografike ku përfshihen emrat e lumenjve, maleve, krahinave, kufinj të gjeografikë të tyre etj. Ka të dhëna me karakter ekonomik ku tregohet për llojet e bimëve që kultivoheshin, për prioritetet, për gjendjen ekonomike të popullsisë, për monedhat, për shërbimet që ofroheshin si fetare ose edhe shëndetësore, deri edhe kirurgjikale.

Nisur nga këto informacione që përfshin ky dokument, është konsideruar nga studjuesit e huaj dhe më vonë edhe nga ata shqiptarë, si dokumenti më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. Por nëse një relacion i ngjashëm i Zmajeviqit i vitit 1703 është publikuar i plotë dhe me fare pak gabime, dokumenti i Gasparit, megjithëse mjaft më me rëndësi, akoma edhe sot e kësaj dite është publikuar vetëm pjesërisht dhe me shumë gabime, të cilat vazhdojnë të merren në konsideratë si burime historike të sakta dhe të prodhojnë shkrime me gabime, të cilat nganjëherë shkojnë deri në tjetërsimin e realitetit historik.

Fajta e parë e “Relacione për Gjendjen e Shqipërisë në Shek.XVII-XVIII” me autor Mark Palnikaj, i sapodalë në libraritë e vendit



Si u zgjodh Gaspri dhe zhdukja e kopjes origjinale

Nga të dhënat arkivore merret vesh se dërgimi i Shtjefën Gasprit në Arbëri, për të raportuar për gjendjen e kishës katolike në këto treva, por edhe për gjendjen sociale dhe shoqërore të popullsisë së tyre, është iniciuar nga vetë Papa Klementi X dhe është ndërmarrë nga organet më të larta të shtetit të Vatikanit.

Ai është përzgjedhur për këtë mision, sepse ishte me kombësi arbërore, njihte gjuhën dhe zonat në të shtatë dioqezat me popullsi shqipfolëse, kishte mbaruar me sukses Kolegjin Ilirik të Loretos dhe Kolegjin Urbanian në Vatikan, dy nga shkollat e larta më në zë të kohës.

Në fillim, ofertën për të kryer një mision të tillë, ai nuk e ka pranuar me pretendimin se i rrezikohet jeta nga turqit që kishin pushtuar këto zona dhe se i kishin ofruar një pagesë të pamjaftueshme. Mbas disa muaj bisedimesh midis tij dhe eprorëve, është rënë dakort që ai të vizitonte dioqezat që kërkohej, jo si përfaqësues i klerit por si një turist, qytetar i thjeshtë kundrejt një shume shumë të madhe monetare për nevojat e shërbimit, si ushqim, fjetje, pagesë për kuajt dhe shoqëruesit dhe për ryshfetet, nëse do t'i nxirrnin pengesa.

Në dokumentet e ruajtura në Arkivin e Propogandës së Fesë në Vatikan (APF) del krejtësisht e qartë që Gaspri dërgohej në misionin e tij, jo si relator, por si eksplorator dhe raporti që ai duhej të sillte duhej t'i tejkalonte përmasat e një relacioni.

Raporti mbi gjendjen në Shqipëri që do praqiste ky eksplorator, duke mos qënë vetë i punësuar në këtë vend dhe duke mos patur edhe lidhje personale me personelin që shërbente në këto dioqeza, ishte i përjashtuar nga konflikti i interesave dhe do të ishte shumë afër realitetit dhe larg manipulimeve për interesa personale.

Prandaj ka kaq shumë rëndësi gjetja dhe publikimi korrekt i këtij dokumenti.

Në Shqipëri, ky dokument është publikuar për herë të parë në revistën Hylli i Dritës në katërbëdhjetë numra gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1932 i shkruar në

gjuhën italyane.

I pari që ka reaguar mbas këtij publikimi ka qënë studjuesi Fulvio Kordinjano, i cili në vëllimin e tretë të librit të tij me titull “L’Albania a traverso l’opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi S. I. 1847-1914”, botuar në Romë në vitin 1934, i ka kushtuar këtij dokumenti një kapitull të tërë, atë të dhjetin, duke i bërë një analizë të thellë historikut të tij dhe publikimit në revistën Hylli i Dritës.

Ai ka shkruar se ka kërkuar kopjen origjinale të këtij dokumenti në arkivat italiane të kohës dhe nuk e ka gjetur. Në vazhdim të punës së tij, ai ka lexuar kopjen e këtij dokumenti që ishte i ruajtur në fondet e APF në Romë.

Mbas studimit të vëmendshëm të kopjes dhe të revistës, ai ka arritur në konkluzion se publikimi në revistën në fjalë përmban më shumë se njëqind gabime që vinin nga pamundësia e leximit dhe rishkrimit të realizuar nga paleografët që janë marrë me këtë punë.

Në respekt të aftësive të tij si studjues dhe të dashamirisë së tij për Shqipërinë, po e sjellim të plotë pjesën kryesore të kapitullit X të librit që cituam më sipër. Po i vendosim të shkruara në gjuhë shqipe faqet nga 321 deri 327 të këtij libri. Siç mund të shihet më poshtë, Kordinjano nuk i quan relacion por dokument këto shkrime të klerikut shqiptar Shtjefën Gaspri, të njohur simbas emrit të shkruar në gjuhën italiane Stefano Gaspari:

SHËNIME HISTORIKE MBI VIZITËN NË KISHËN E ARBËRISË DHE TË SERBISË TË KRYER NGA D. SHTJEFËN GASPRI

“Në kohën kur është shkruar ky dokument, një pjesë e veriut të Shqipërisë së sotme emërtohej Arbëri dhe Dioqeza e Shkupit e cila përfshinte të gjithë teritorin e sotëm të Kosovës dhe Shkupin me rrethina, emërtohej Dioqeza e Serbisë (Diocesi di Servia)

Dokumenti i D. Shtjefën Gasprit, nga i cili kemi nxjerrë një statistikë të përmblodhur për çdo dioqezë, pas vizitës së bërë dhe të përshkruar nga Imzot Marino Bici i Arbes (Dalmacia), Arkipeshkvi i Tivarit (nga 1608 deri në vitin 1625), është më i rëndësishmi për të gjithë shekullin XVII.

Në të vërtetë, ky dokument të bën të shohësh kushtet jo vetëm të dy viteve (1671-1672), gjatë të cilave Gaspri përshkon Arbërinë katolike, por të bën të kuptosh të gjithë grumbullin e dokumenteve të Propaganda Fides, të cilët referojnë kushtet e lartpërmendura fetare të Katolicizmit arbër.

Kemi përmendur ndonjë gjë në serinë e parë të dokumenteve, në Shtesën e Volumit II. Këtu del e nevojshme të bëhet e

dyqind gabime. Kopja që ruhet në Vatikan ka ndryshime të dukshme sepse ka të shkruara të dhëna që kopja e Napolit nuk i përfshin.

Ajo është shumë më e plotë se kopja e Napolit dhe ka disa paragrafe shkrime më shumë, me të dhëna që kopjuesi që ka shkruar kopjen e Napolit i ka lënë pa i shkruar për motive që për ne nuk janë të qarta.

Një hamendësim mbi mospërfshirjen e disa paragrafeve në kopjen e Napolit, mund të jetë që ai u kopjua jo i plotë, për të ruajtur disa të dhëna, që për atë kohë mund të konsideroheshin sekrete. Kjo ide e jona mund të konsiderohet vetëm një hamendje, e pa bazuar në të dhëna konkrete. Arsyeja e mos përfshirjes në kopjen e dokumentit të këtyre paragrafeve, mund të jetë krejt tjetër nga ajo që mendojmë ne.

Nisur nga ky fakt, jemi të mendimit që duhet kërkuar në arkiva të tjera, për të bërë të mundur gjetjen e kopjes origjinale të shkruar nga autori, nëse ajo është ruajtur, dhe të bëhet rishkrimi dhe publikimi nisur nga kopja origjinale. Mbasi këtë gjë ne nuk e kemi arritur, atëherë kemi rishkruar korrektësisht kopjen që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fede.

Jemi të mendimit që kopja origjinale mund të ndodhet në Arkivin Sekret ose në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Apostolike në Vatikan. Nëse dokumenti origjinal do të gjëndet dhe të publikohet, atëherë do të zhdukej çdo hije dyshimi mbi saktësinë e publikimit tonë.

Deri sot ky relacion është botuar dy herë por në të dyja rastet jo i plotë. Botimi i parë, siç e thamë më sipër, u botua në revistën Hylli i Dritës. Ky botim nuk është i plotë sepse nuk është e plotë kopja që gjëndet në Bibliotekën Shtetërore të qytetit të Napolit.

Botimi i dytë i tij është bërë nga albanologu Peter Bartl, në serialin e botimeve të tij Albania Sacra në 4 volumet e para.

Ai ka botuar, sipas kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fede në Vatikan, të dhënat për Dioqezat e Durrësit, Lezhës, Sapës dhe Pultit. Nuk ka botuar akoma të dhënat për Shkodrën, Tivarin dhe Shkupin. Pra edhe ky botim është i pjesshëm, sepse nuk ka të shkruar tre nga shtatë dioqezat e përshkruara në relacion.

Për këtë arsye ju vumë punës, për një publikim të plotë të kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fede, edhe pse është kopje e dokumentit, dhe jo origjinali i shkruar nga autori i këtij relacioni, por sepse është më i plotë.

Për të bërë një punë sa më cilësore ne vepruam në këtë mënyrë:

Morëm në mënyrë elektronike, të skaneruara me ngjyra, të dyja kopjet e dokumenteve në arkivat përkatëse. Riproduhuam nga një kopje për secilën në format A4 të shkruar bardh e zi dhe jo me ngjyra dhe i lidhëm si libra të veçantë.

Morëm nga revistat Hylli i Dritës të gjithë numrat ku ishte botuar dokumenti dhe riprodhuam një kopje të plotë të këtij botimi për ta patur si referencë për rishkrimin që do të bënim, por edhe për të kontrolluar saktësinë e përputhjes me kopjen nga e cila është botuar.

Vendosëm në tavolinën e punës tre kompjuterë rresht dhe shfaqëm në dy monitorët anësorë kopjet e dorëshkrimeve nga dy arkivat e përmendura. Kjo gjë na krijoi mundësinë që të shohim me ngjyra dhe të zmadhuar deri në 200% kopjet e dokumentit.

Të dyja publikimet e mëparshme të dokumentit i krahasuam me kopjet arkivore në dorëshkrim.

Mbas një rishkrimi me vëmendjen më të madhe të këtij dokumenti, vumë re se botimet e mëparshme kishin mospërputhje me kopjet dorëshkrim në mbi 670 raste në të 208 faqet e rishkruara.

Këto mospërputhje, jo gjithmonë e tjetërsojnë kuptimin e dokumentit por në disa raste kishte edhe gabime të pale-

jueshme të cilat e ndryshojnë shumë kuptimin e tij. Ky tjetërsim, sjell pështjellim shumë të madh për studjuesit që shkruajnë histori me të dhënat që ofron ky dokument.

Mospërputhjet më të rëndësishme janë; harrimi pa shkruar i disa fjalëve, shkruarja gabim e shifrave në disa raste, shkruarja gabim e emrave të vendeve në disa raste dhe të tjera gabime më pak të rëndësishme. Kompjuteri na ndihmoi që të bëjmë regjistrimin e të gjitha këtyre mospërputhjeve dhe korrigjimin e shumicës së tyre. Në disa raste kemi vendosur shënime sqaruuese në fund të faqes.

Përkthimi në shqip i dokumentave është bërë sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nganjëherë kemi toleruar duke i qëndruar besnik kuptimit të fjalisë në origjinalin italisht. Është si të thuash një përkthim i lirë, çka nënkupton përkthimin me saktësi të mendimit, dhe jo domosdoshmërisht përkthimin fjalë për fjalë të tekstit.

Kjo është një punë e vështirë, që ka kërkuar shumë mund dhe kohë por ne jemi munduar të bëjmë më të mirën e mundshme.

Ne u munduam që këto gabime ti zvogëlojmë sa të jetë e mundur më shumë, por nuk mund ta themi me gojën plot se me këtë botim nuk ka më asnjë gabim ose mospërputhje. Ka disa emra të pajisjeve kishtare, të monedhave, një-sive matëse të peshës dhe sipërfaqeve të cilat sot nuk përdoren më dhe nuk i kanë fjalët korresponduese në gjuhën shqipe. Për këtë shkak, jemi të detyruar që këto fjalë t'i lemë në tekst ashtu siç janë dhe të vendosim në fund të librit një fjalor me shpjegimet përkatëse për secilën fjalë.

Përveç dokumentit të Gasprit të vitit 1671, po vendosim në këtë botim edhe katër dokumente të tjerë të cilët ne i konsiderojmë me rëndësi, sidomos për historikun e dioqezave dhe të fiseve në zonën verilindore të Shqipërisë. Kemi sjellë për

botim një relacion të vitit 1675 të Shtjefën Gasprit, të shkruar me dorën e tij, në pesë faqe format i vogël.

Kemi sjellë edhe një relacion të vitit 1697 të shkruar nga Fra Egidio nga Armano. Dorëshkrimi përmban 17 faqe dhe sjell të dhëna me shumë rëndësi për ndryshimet në sjelljen e pushtuesit turk ndaj popullsisë së fiseve të besimit katolik në veri të Shqipërisë, mbas luftës Austro-Turke të vitit 1689 dhe për qëndruesen e këtyre të fundit.

Relacioni tjetër që kemi vendosur në këtë botim është ai i Fra Filipit nga Shkodra, vetëm dy faqe por me rëndësi shumë të madhe për informacionin që përcjell. Po botojmë edhe pjesën prej 11 faqe të relacionit të vitit 1703 të Vinçens Zmajeviqit, ku flet për Dioqezën e Pultit, ku përfshihet edhe Tropoja e sotme. Këtë pjesë të relacionit të Zmajeviqit e kemi marrë nga fondet e Bibliotekës Apostolike në Vatikan. Kemi konsultuar edhe kopjen e plotë të këtij dokumenti që ndodhet në APF.

Këto dokumente janë shumë të rëndësishme për historinë e Shqipërisë, por kanë rëndësi të veçantë për historikun e fiseve Nikaj, Mërtur, Gash, Krasniqe por edhe për fise të tjera. Ne kemi mendimet tona për zhvillimet politike dhe shoqërore të ndodhura në atë kohë në fiset dhe krahinat për të cilat flitet në relacione por e pamë me arsye që të mos bënim komente por t'ua lëmë në dorë studjuesve të tjerë nga këto zona, për të bërë komente dhe për të nxjerrë konkluzione, për atë se çfarë ka ndodhur në fund të Shek. XVII dhe në fillim të Shek. XVIII në ato zona.

Ndoshta më vonë, mbasi të marrim në studim edhe disa relacione dhe dokumente autentike të tjera, mund ta themi mendimin për historikun e asaj periudhe, në një tjetër publikim tonin me një këndvështrim më të gjerë.

Redaksia

ENDRRAT DHE DOMETHËNIA E TYRE SIPAS TEORISE TË MADHIT DR. ZIGMUND FREUD

“JETA E DYTE” E NJERIUT

-Leëis Carol thekson: “çfarë është jeta nëse nuk është ëndërr?”

Në të shkruarën jo shumë të largët ëndrrat kishin pse të pa numërto. Megjithatë shkenca filloi të merret me ëndrrat vetëm kur mjeku i famshëm vinez Z. Freud (Froidi) në 1900 publikoi interpretimin e ëndrrave, interpretim i cilësuar i famshëm, ku ai tregoi qarte dhe në mënyrë të ndershme dhe me intuitën që karakterizonte vetëm atë, ku iu kundërvu psikologëve dhe psikiatërve të tjerë të kohës së tij-ai vuri në bazën e ëndrrave seksualitetin; ai karakterizonte ëndrrat si valvule që hapet nga represioni (shtypja) e dëshirave tona të vërteta, por që prodhohen nga subkoshienca, si kundërvënie për të shpëguar këto dëshira që ziejnë (gëlojnë) nga brenda në se nuk i nxjerrim jashtë....

Por, që 2000 vjet më pare, filozof si Eppiteto theksonte: - “njihni ëndrrat tuaja-konsultoni ëndrrat tuaja”. Dhe sot, në

kohet moderne kemi çelësin e ëndrrave nga psikologë, psikiatër, neurolog, fallxhi e të tjerë.

Ç ‘është ëndrra?

Ëndrrat shoqërojnë në mënyrë të vazhdueshme gjumin tek njeriu. Ëndrrat janë baza e realitetit, ato i gjallërojnë dhe i çlirojnë njerëzit. Ëndrrat janë me ngjyra te bukura, erotike, tmerrues, gazmore, të zymta (melankolike), por në fund të fundit të fshehta e misterioze, ëndrrat janë shëmbëllim (përngjasim); imagjinim i jetës tone, janë fakte tonat. Ato gërshtohen me ambientin e përditshëm të punës, të familjes, të momenteve intime (dashurore), reflektojnë emocionet tona, zbulojnë shpresat tona, interesa, probleme, frike, dëshira, sekrete, shpesh madje gjera që as me veten tone nuk i kemi sjelle në mendje (përmend.) Por, ëndrrat nuk janë të gjitha të njolloji (të barabarta), disa qëndrojnë të gjalla në kujtesën tone, mbahen mend për vite me radhe, na

ndihmojnë të kuptojmë, të parashikojmë fakte konkrete, here pas here insistojmë në ëndrrat tona, kur riprodhohet shumë here po e njëjta ëndërr, por në distancë kohore. Pra, është riprodhim i të vjetrave, por që përfundon si ëndërr, që dalin nga “dera e fildishte” do të thotë se kane vlere vërtet, që mund të interpretohen si mesazh i Hyut (Zotit). Pra, ndryshojnë nga të tjerat, që sikur dalin nga dera e pasme e bririt (porta di cornu), të cilat janë më të pa kuptimta, më trashanike, ëndërr që zgjidhen menjëherë pas zgjimit, gjate marrjes së kafes së mjesit, gjë që e ka burimin në një mbingrenje, nga mungesa e gjumit, ose nga ato çfarë kemi pare në realitet, nga mendimet e dëgjimet gjate ditës. Pra Froidi i çmonte ëndrrat se ishin dritare e subkoshienca (e pavetdijes) dhe shumë studime sot e çmojnë se ai kishte të drejte. Sipas shumë studiuesve ëndrrat zgjasin nga disa sekonda deri 45 minuta dhe deri 4-7 ëndrra në nate, por aftësia për

t'i mbajtur mend varet nga personaliteti i individit. Sipas Froidit vetëm fëmijët shumë të vegjël janë të lire nga rregullat dhe fantazia (imagjinata) ëndërrojnë dëshirat e tyre thjeshte ashtu si i duan-si gjirin e nenës, çokollata, ëmbëlsira e të tjera. Emocionet e të rriturve sidomos meshkuj janë të lidhura me sferën seksuale, janë aq të forta sa që nuk i lenë të flejë natën, kanë shqetësime. Kështu e pa njohura e maskuara u korrespondon simboleve të tjera si eksperiencia ditore mezi e përshkueshme, që e transformon ëndrrën me një enigme speciale (te panjohur), ku çdo detaj, çdo imagjinim vihet në vendin e tjetrës (pra zëvendësohet), duke bere maskimin, sa që nuk mund të njihet. Kështu ëndërrojmë mace, gjarpër, kalë (që zëvendëson penisin), agresion (dhune), ose larg seksualitetit si shpella, uji (për nenën), shtëpia (për trupin), kantina dhe banja (për gjenitalet). Ne fakt përmbajtje e ëndrrës varet nga një

seri procesesh-ndjenje, emocionet, gjendja psikikë e fizike, shpirtërore, ankthet, stres-i, marrja e alkoolit sot dhe e drogës, pagjumësia. Urrejtja në ëndërr del në urrejtje për një tjetër. Dashuria apo respekti shpreh disa dëshira të pa realizuara gjate ditës. Ëndrra bardh e zi tregon për ankth të forte. Kur sheh ujë të piste flet për probleme të pazgjadhura. Nganjëherë agresioni personifikon simbolin e fitimit ekonomik. Pamja në ëndërr e shtëpisë, tregon gëzim, por vila tregon lumturi, shiu, tregon problem ekonomik, stuhia simbolizon aksident e të tjera.

Në këtë pike, për të interpretuar ëndrrën nuk duhet të gërryem në thellësi, të çmontojmë dhe të punojmë mbi çdo pjese të vetme, por të lidhen fjalët, mendimet, kujtimet deri sa të gjejmë filin e lëmshit të sekretit të ëndrrës.

Jung: Ëndrrat si mesazh...

Nga e kundërta e Freud Z; psikologu zviceran K. Jung, i cili studio me vëmendje simbolet që zvarriten prapa në magazinën e erret të së panjohurës (inkoshiences) jo vetëm si bagazh i jetës tone, por dhe si trashëgimi, e paraardhur, që trashëgohen në kodin gjenetik, si gjatësia, ose ngjyra e flokëve e lëkurës. Jung ringjalli mentalitetin e vjetër (antikitetit): të simboleve që mbushnin ëndrrat tona, duke i pare si mesazhe, të vlefshme, këshilla të mbushura me enigma (të panjohura), ose pjesën më sekrete dhe merret nga vetja, të afte të komunikojnë pa fjale me qenie të tjera.

Teoritë e fundit

Nga këto pionier të interpretimit të ëndrrave ka kaluar shume ujë i rrjedhshëm nen ure bosh. Sot ëndrra është konsideruar si një sistem alarmi në përballje me sëmundjen akoma në fazën e zhvillimit, si një "lavash" emocionesh ndaj toxinave të grumbulluara në sistemin nervor për të forcuar kujtesën dhe vihet në lëvizje kreative (për krijimtari).

Me në fund hipoteza kurajoze e neuro fiziologut amerikan Allan Hobson- sipas të cilit arti i ëndrrës do të jete një gjimnastike për mendjen, që tenton të bashkoje, të lidhe të gjithë impulset nervore, që bombardojnë me raste disa zona të trurit tone.

Kur lind ëndrra?

Për një kohe të gjate besohej se fabrika e ëndrrave gjendet në zonën e jashtme të trurit i ashtuquajtur cortex (korja e trurit). Por duket se përgjegjëse e skenës onorifike (jo reale) të ëndrrës është truniku cerebri - fushe pak primitive ku njeriu ndahet prej shume speciest shtazore, ku është i afte të prodhoje ëndrra, mjafton të vëzhgohet dhe të ruhet një qen ose mace që flenë dhe shikohet se si lëvizin ansite (gjymtyrët), me zhurma, murmurima. Pra, duket se po ëndërrohet diçka-nene, babai ose diçka misterioze.

E njëjta gjë ndodh me të porsalindurin ose për beben e ardhshëm në barkun e nenës. Por ëndrra fillon me daljen në jete (në zanafille), para se të filloje zhvillimi i koshjences (ndërgjegjes), i ndjenjave, i kujtimeve.

Por në se fillojmë e ëndërrojmë para se të krijohet eksperiencia, do të thotë se materiali i ëndrrave, bagazhi i figurave dhe simboleve që shfaqen çdo nate, gjenden brenda tyre. Pra, ka një fakt, që vërehet te të verbrit, që megjithëse nuk shikojnë ëndërrojnë formën e sendeve dhe ngjyrën

sido që nuk e kane pare kurrë.

Koha e ëndrrës

Zbulimi u bë, kur dy shkencëtar At-erinskij dhe Keitman lidhen një person, që flinte me një aparat Elektro-encefalograf dhe vërejtën x se ëndrrat shfaqeshin në fillimin e gjumit gjate natës. Gjumi nuk është konstant, uniform, por kalon përmes 4 (katër) fazave të ndryshme të ashtuquajtura fazat REM (lëvizje të



syve), ku kemi alternim të momentit të thellësisë, ku privohet nga ëndrra të tjera më të thjeshta të tejmbushura me figura onirifike (arealë)-ëndërrues - në të cilin rrethi cerebral ka vlera dhe shpesh të tipike të zgjimit, sido që muskujt bëhen të rende, me frymëmarrje të zhurmshme -gulçues dhe me lëvizje të shpejta të syve nen çepallat e mbyllura.

Dhe çdo nate përjetojmë nga tre deri pesë faza ëndrrash pas rreth 1 (një) ore e gjysme nga zënia e gjumit dhe që zgjat rreth 10 minuta dhe tjetra pas saj është me vazhdim më të zgjatur. Janë këto ashtu te quajtura ëndrra te bardha, sipas lashtësisë janë të vetmet të besueshme dhe janë ato që mbahen mend më mirë me mjaft veçori.

Sipas studimeve te Serbis Jovanovic, faza e gjumit nuk janë të barabarta në mosha të ndryshme të jetës së personit. Ka mundësi që bebja në barkun e nenës ëndërrohet thajse gjithë kohën e gjumit dhe i posa linduri gjysmën e kohës së gjumit, të moshuarit ëndërrojnë pak dhe personat afro 100 vjeçar nuk shohin thajse ëndrra fare.

Gjumi në shifra

Përmbushja e dëshirave, zgjidhja e problemeve ndihmon për t'u përshtatur në jete, megjithatë jo të gjithë njerëzit mund të kenë një raport të mirë me ëndërrta e veta. Sipas studimeve të mirëfillta gjysma e italianeve kane ëndrra të shpeshta, por vetëm 1 në 4 (katër) vete arrijnë të kujtojnë përmbajtjen e tyre. Dhe mund të jene me fat që shohin ëndrra të këndejshe (të lezetshme) afro 25-30 % e tyre, ka një pjese prej 20-25 % neutral, por pjesa mbetës prej 50 % kane ëndrra të mbushura plot me tmerr (terror). Por sa është sasia e ëndrrave që shohim? 60 % e

personave ëndërrues shohin mesatarisht 1 (një) ëndërr në muaj, 15 % e ëndërruesve shohin deri 4 (katër) ëndrra në jave. Por realiteti duket se është më i madh, të paktën 1 ëndërr në dite, ato që arrijnë të sjell në kujtesë ëndrrat janë vetëm 6 % ëndërruesve. Sipas shifrave mund te themi se 1 ore e gjysme çdo nate me një total prej 20 ditësh ne muaj, gjate gjithë jetës shihen 400 (katër qind) ëndrra.

nga Bohri, makina qepëse e Poland e të tjera.

Në ëndërr shikon sikur: të ndjekin, ecje zbathur, sikur "bën dashuri, sikur fluturon ose sikur humb një dhemb; sikur u paralizove e nuk lëviz dot, sikur bie nga lartësia, sikur merr një post drejtues, sikur kthehesh në fëmijëri, ka një liste të ëndrrave më të shpeshta me lëkundje sipas seksit, kulturës, moshës, kushteve social-ekonomike. Të pa shkollat e bujqit u japin rendësi ëndrrave të gëzueshme, menaxheret dhe tregtaret preferojnë ti harrojnë ëndrrat.

-Sipas sekrit, burrat në 33 % -shohin ëndrra, ndërsa grat janë më ëndërrues 46 %. Në ëndërr shikohet, burri, fëmijët, shtëpia, ka ëndrra të shpeshta në shtazani, në një faze delikate tranzicioni, munden konflikte, kështjella, gradacele, kufoma, engjëll, prift e të tjera.

Sipas studiuesit Amerikan, të ëndrrave, Calvil Hall, në 1950 dallimi midis ëndrrave të burrave e të grave është evident-burrat ëndërrojnë rivalitet, pune sex-grate kane ëndrra afektive (ndjenja), për fëmijët, familjen, ushqimet e të tjera.

Si interpretohen ëndrrat?

Një ëndërr e pa interpretuar është si një letër që nuk hapet asnjëherë sipas Talmund. P.sh, nëse sheh vdekjen, në disa kultura të shohësh vdekjen është diçka e mire, sipas disave kjo tregon lindje. Pra, tregon ndryshim tek vetja dhe tek të tjerët - kështu nena po të shikoje vdekjen e bebes së lindur tregon përgjegjësinë e saj për kujdesen dhe është e shqetësuar se mund të ndodh e keqja. Pra, kjo tregon se sa e çmuar është jeta, por dhe lajmet e këqija të ditës na shkaktojnë shqetësim.

Ëndrra sikur po rrezohemi ose biem nga lartësia-kjo tregon për aventura në jetë nuk keni kontroll mbi vetën. Po ashtu tregon për ndryshime që u presin.

Nëse shihni sikur u ndjekin, u përgjojnë-kjo tregon për një çështje që nuk është mbyllur, ose jeni i shqetësuar për të kaluarën dhe frikoheni se u ndikon mbi të ardhmen.

Nëse ndihesh i tradhtuar: kjo më shumë tregon për frike se mos të tradhton bashkëshorti (ja), ose kur ka livadhis në të shkuarën, por kjo ndodh kur mërdehzejt ndjehen mire.

Sikur ke humbur një dhemb, në disa kultura kjo tregon friken për humbjen e një të afërmi, por sot më shumë tregon për humbje të pasurisë, pra ka probleme me parat.

Po të shohësh në ëndërr një shtëpi, tregon për vendin që kemi në bote, pra jeni të organizuar, por keni nevojë për pushim.

Pra, sot në kohet moderne në saje të zbulimeve të psikiatëve e psikologeve kemi në dorë çelësin e ëndrrave, por ruajtuni e mos bini në dorën e falloxhoreve dhe të mashtruesve, që u ngatërrojnë jetën me falle e shtriga e të tjera, duke u dhënë nuska e të tjera e të tjera.

Kujdes!

Përgatiti: Dr. Med. Ndue NIKAJ,
Shkodër

Po kush nuk ëndërron?

Disa persona rreth 7 % mendojnë se nuk përfshihen në ëndrra, por shkencërisht kjo është e pa mundur, se të gjithë njerëzit ëndërrojnë pa ndërprerje, sepse ëndrrat janë një aktivitet i trurit me rendësi për të mbajtur ekuilibrin, pa ëndrra marrosemi. Por shpesh preferojnë disa persona të mbyllin imagjinatën, pra bien në krize dhe bindin vetën sikur nuk ëndërrojnë; Mungesa e koherencës logjike dhe transformimet aq të shpeshta që ndodhin gjate ëndrrës e vështirësojnë rikujtimin e ëndrrës. Në çdo rast kur kemi përshtypje të zgjatura, pak minuta na ndajnë nga zgjimi ose ka modifikim ose kemi një fshehje pjesore. Dhe sapo të zgjohesh duhet ta shënosh shpejt, ose t'ia tregosh dikujt (ndokujt) para se të zë gjumi duhet të përsëritësh disa here fjalët: "Nesër do të kujtoj ëndrrat e mia".

Në antikitet njerëzit përmes ëndrrave bënin llogari të mëdha, konsideronin ëndrrat si profeci, magji. Kështu në Romen e Cezarit ëndrrat i kalonin profetit. Në fakt në zonën e panjohur të psikikes, mbetja e ngjarjeve te ditës, frika, komplekset, kujtimet, përfshihen dhe fragmente të kombinuara në planin intim, si fenomene paranormale, perceptime ekstra-sensoriale që kane lidhje me të ashtuquajturën telepathi-largpamse, parashikimi ngjarjes ka ëndërrim pa element objektiv. Ëndrra katalizën mesazhe, këshilla, riprodhim, informim e të tjera,

A ka krijimtari në ëndërr?

Në gjumë jemi më krijues se sa zgjuar. Historia e artit dhe e teknikes na afron një "det të tere" shembujsh: si frymëzim, përgjigje, vendime, zgjidhje.

"Komedia hyjnore" e Dantes vinte nga një ëndërr e tij, kështu modeli i atomit

LAMTUMIRË ZEF FUSHA

Me hllërim të madh morëm lajmin për ndarjen nga jeta të bashkëshortit shembullor, prindit dhe gjyshit të ëmbël, mësuesit të përkushtuar, kolegut të mirë, dashamirit e bashkëpunorit, dashamirit të Dukagjinit dhe dukagjinaseve e shumë më gjerë ZEF PJETËR FUSHA. Kjo sëmundje e pabesë na e mori Zefin kur nuk e prisnim. Ai do të na mungojë shumë, por dihet se më shumë do ti mungojë bashkëshortes Kartinë, ose Katit siç i thoshte me plot dashuri Zefi, djemëve, nipave e mbesave, familjarëve dhe të afërmëve, do ti mungojë miqëve e kolegëve të punës ku punoi me dekada, do ti mungojë shoqërisë së shumtë të tij, do ti mungojë Shalës e Dukagjinit ku punoj pa u kursyer për vite e vite, do ti mungojë edhe Shkodrës ku punoi dhe banonte.

Me poshtë kam shkëputur pak copëza të vogla nga fb im, të disa prej atyre që kanë shkruar këto ditë, pas largimit të Zef Fushës jeta.

Ndue Vatnikaj
“... Një vdekje e trishtë që na lëndoi zemrat pa masë...”

Mynyr Gojashi
“...Ngushllime Katrinës, fëmijve, shokëve e dashamirve...”

Gjon Dushaj nga shqiptarët në Malin e Zi, Tuz

Ngushllime
Gjovalin Shyti, Itali
“Ngushllime familjes të afërmëve shokëve miqve...”

Ndue Sanaj
“... keqardhje për vdekjen e shokut e mikut tonë, anëtarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Zef Fusha...”

Ngushllime bashkëshortes së tij, Katrinës! Ngushllime djemve e gjithë atyre që i pati të dashur!

Zef, lamtumirë!
Lazer Kodra
“...Ky ishte njeriu, i cili që nga lindja e derisa ndërroj jetë dha për shoqërinë shumë më shumë se sa mori prej saj.

Prek Gila, Angli
“...Largim i parakohshëm për në amshim i drejtorit, ka lënduar gjithë ish-nxënsit jo të pakët, dhe pse jo, mbarë komunitetin ku punoi e jetoi.

Hil Alija, nga Puka, me rrënjë në Theth, dhe aktualisht banon në Durrës
Ngushllime për familjen e për ju shokët dhe miqt e Zefit

Zija Vukaj
“Sa lajm i hidhur! Një mik i mirë, intelektual dhe burrë i fisëm. Koleg i pa-



harruar...”
Gjergj Leqejza
Sa keq! Ngushllime familjes e miqve!
Tom Bungaja

“...Ishte një nga figurat më të mira që jetën e tij ja kushtoi punës, familjes, shoqërisë...”

Vjollca Funiçi Kapaj
Pushoftë në paqe
Zef Pali

“Me hllërim të pa masë mora lajmin për vdekjen e profesorit të paharruar Zef Fusha...”

Nikoll Grrela, SHBA
Ngushllime familjes, ky virus në Dukagjin po zgjell burrat e mir!

Ded Durgaj
“Me dhimje Po mesoj kete lajm per ndarjen nga jeta te komshiut tim, mikut e dashmirit per disa dekada...”

Gjin Musa, Itali
“...Zef Fusha që gjithmonë më thirre nipash e të thirra dajë sa shpejt na ike nga kjo jetë, e nuk na thë asnjë fjalë... Na këpute gjunjët, prisja të takoheshim bashkë në Shkoder... Lamtumir mësuesi, shoku, daja e biri i Breglumit të Shalës.”

Gjyste Çarku Bici
O zot, sa po me dhimet, krishti e pastë në Parris...”

Zef Bari
Ngushllime ... për ndarjen nga kjo jetë e Zef Fushes. biri i një familje të veçantë të Shalës, intelektual, familjar, e shok me shumë cilësi e vlera...”

Zef Temeli, Itali
“Pastë dritë e dielli krishti e pastë në

Parris.”
Pashko Ara
“...emri personaliteti dhe vlerat që ka mbartur për çdo njohës afër e larg tij në jetë mbetet i paharruar...”

Gjelosh Vuksani
“...mësues Zefi ishte e do mbetet në kujtimet tona si mësues i veçantë i Dukagjinit...”

George Rakaj
“...njerëz të modelit të tij i mungojnë njerëzimit e i dhimen gjithkujt...”

Dedë Preka
“Burrë zotni, pushoftë në paqe...”
Rexhep Abazi, Lugina e Preshevës, Kosovë

Ngushllime.
Prek Zina Gjonaj, SHBA
Ngushllime Familjes e farefisit të tij.

Sefedin Istogu, Kosovë
ngushllime
Sokol Halili, Kosovë

Ngushllime bshkëshortes Katrinë, ty Luigj Shyti, Shalës e Dukagjinit...”

Pajtim Ribaj, Tiranë, “Ngushllime familjes!”

Marije Martini Stani, Belgjikë
“Më është dhimt në shpirt...qysh se isha fëmij i mbaj mend kujtimet e familjes Fusha me familjen tonë te Baba. Ishin të mrekullueshme të gjithë.”

Mark Gjoni
Zef Fusha miriton shumë. Ai ishte koleg, mësues e drejtor shumë i talentuar.

Gjon Fierza
Ngushllime për familjen, të afërmit, miqtë dhe kolegët.

Marie Vocaj
Ngushllime Katerina zoti të ruejt fëmijët, nipa e mbesa

Illir Grima, Angli,
“... zoti e forcoftë familjen dhe të afërmit e ti...”

Fran Rrushaj, Greqi,
“...Zoti i forcoftë familjen e të afërmit e tij

Ndue Ftoni, SHBA
Me keqardhje e mora këtë lajm. Ngushllime familjes

Nikolin Shyti, SHBA
Zoti forcofte familjen dhe te afermit e Zefit, e shpirti i ti pushofte ne paqe

Mark Shpella, Angli
Zoti i forcoftë të afërmit e tij e Krishti e pastë në Parrisë!

Prele Milani
Iku edhe Zefi... E pata mësues në klaset epërme të 8 vjeçares, me pas epror e koleg.

Jo, jo nuk më besohet!
Ju Gjeto ju mori Zoti pranë vetit se ishte njeri i Zotit dhe si tillë nuk meritoni të qaheni e te vajtohet si pagan.

Ju ishte një kristian i mirë.
Zoti të përkëdheli në jetë, të dha dhuratë një familje punëtore e bujare të konakur si mali me dushk e barë. Një kullë lridashëse me dy lapidare martire atdhetarie Pal Kola dhe Kolë Marku të shkimur në lule te rinisë.

U rrite në një ashtë me lisa te vjetër rinuar me picak të hijshëm e lule të njoma fëmijve nipa e mbesa.

Zoti të dhuroi shëndet dhe virtyte sh-

E çmoja si model i mësuesit të përgatitur e metodist. Qe një nga bashkëpunëtorët e fillestar të Shoqatës Dukagjini dhe vazhdimisht përçues i vlerave të tij.

Shemi Krasniqi profesor në Universitetin e Prishtinës.
Ngushllime...

Lulash Vatnikaj
“...Për të gjithë ata që e njohin dhe kanë patur lidhje me të, një brengë e madhe, dhimbje dhe lotë...”

Nikë Çarku
“Ngushllime familjes dhe të afërmve. Gjithashtu ngushllime të gjithë kolegeve dhe gjithë Dukagjinit për këtë burrë të pa shoq...”

Ben Nika Theth
Burrë i mirë i Shalës e Dukagjinit, shpirti i ti pushoftë në paqe e zoti e forcoftë familjen e ti.

Kolë Malaj
“Ngushllime familjes,te afermve,miqve e shokeve!”

Zef Nika, Belgjikë
“Ngushllime familjes të afërmëve dhe shokëve të Zef Fushes. Humbja e jetes është e dhimshme për këtë mësues të nderuar dhe intelektual të cilin e njoha në mbledhjet e para të Shoqatës Atdhetare Dukagjini.”

Ilir Progni, Itali
Ngushllimet ma te sinqerta familjes te aferme e shokeve te tij per kete burre intelektual dhe kreshnik të Shalës

Gjovalin Gjellaj, SHBA
“Ngushllime zoti ju forcofte ju dhe rrethin familjar e shoqeror të tij.”

Kolë Martin Aramadhi
“...u largue nga kjo jetë një burrë i mirë që kudo ka punu në arsim drejtor ka lanë respekt e pershtypje te mira...”

Maria Ljuldjuraj, Australi
Zoti e forcoftë familjen tij. Pushoftë në Paqe.

Zef Fusha ishte dhe mbetet një burrë, intelektual e fisnik i nderuar i Dukagjinit, Shkodrës dhe më gjerë.

Ngushllime me shumë respekt, bashkëshortes Katrinë, fëmijëve, nipave e mbesave, të afërmëve miqëve e dashamirëve, të gjithë shoqërisë së tij.

Ne kishim nevojë për ty Zef i mirë, por zoti të thirri pranë vetes. Pushofsh në paqe e i lehtë të qoftë dheu që do të mbaj.

Mos u harroftë emri yt o Zef Fusha. Do të kujtohesh shumë, shumë gjatë.
Lamtumirë!

Luigj SHYTI
dhjetor, 2020

embullore. Deri ditën e fundit nuk ditë se çfarë janë ilaçet dhe gjylpanat

Vërtetë vdiqe shumë para kohe kur familja dhe shoqëria kishin nevojë për ju. Por Zoti të shpëtoi nga pleqëria dhe ligësitë tmerrshme te saj!

Të paktën kur vijmë nder varreza duhet të kujtohem se jeta nuk është veç një frymëmarrje.

Pyeteni vetën o njerëz se çfarë jemi kur na len kjo frymë!

Gjeto Çezmja në 56 vite jetë zgjodhi rrugën e drejtësisë dhe nuk humbi kohë rrugicave të ngushta e te errëta të vesit, padrejtësi dhe dhunës.

EDHE NJË ARKIVOLI I MBYLLUR, NË VARGUN E PA MBARIM TË ARMATËS MËRGIMTARE

(Post mortum per ish kolegun Gjeto Prele Çezma)

Ju ishit ende i ri të qaheshit nder varre, ndaj sot Mali Shoshit, Bulli, Kodra e Shqurkut, Rrasa e Palajve dhe shkollat e Shoshit janë mbuluar nga një mjegull zie per vdekjen tande të parakohshme.

Kush e thirri atë vdekje që të shytoj sa

çel e mbyll në mes të Londrës në kohën kur ishte më i mirë plotësuar se kurrë?

-Mos vallë të mallkuan të lumet nga Çijat e Palajve?!

-Mos vallë ta ato patën zili se shtegtove aq larg në një botë të begatë pa mite?!

ANTIBIOTIKO REZISTENCA DHE DISA MASA URGJENTE PER PARANDALIMIN E SAJ

Organizata botërore e shëndetësisë (OBSH /OMS) po i bie kampionës për tmerrin nga antibiotiko-rezistenca. Shpallli erën pas antibiotikeve, kudo ne bote po takohet super bakter rezistent ndaj gjithë antibiotikeve te sotëm.

Cila është shpresa për këtë shqetësim në rritje te antibiotiko-rezistences.

Nevoja urgjente për antibiotik te ri ne bote.

Nga 51 punime për antibiotiket të recensuara nga OBSH vetëm 8 rezultojnë me zhvillim inovativ për të trajtuar agjente rezistente prioritare. 12 superbakteret rezistente më të rrezikshme sipas prioritetit janë:

1. Acinetobakteret Baumannii
2. Enterobaktere - E-choli, Clostridium difficile
3. Pseudomonas aeirogenoza
- 4- entero bakter fekalis
- 5- stafilokok aueuis
- 6- helikobakter pylori
- 7- kompikobakter jejuni
- 8- salmonella
- 9- Neisseria Gonorreha
- 10- streptokok pneumonia
- 11- Hemofilus influeze
- 12- shigella Sonnei

Kështu Evropa flet për 33 mije vdekje si shkak i baktereve multirezistente sipas njoftimit të AFP 01.11.2018, si dhe "Lancet infection disease" publikuar për studimin që nga 2015. Kërkimet kanë përpunuar një nivel kalkulimi të infeksionit dhe të vdekjeve për 5-lloje infeksioni duke u nisur nga të dhënat e rrjetit Evropian EAR-s, shumica e vdekjeve lidhen me bakteret multirezistente, me prioritet primar si acinetobakter, enterobakter, Klebsiela, E-Coli dhe prek moshat nën 12 muajsh dhe nën mbi 65-vjec. Për vitin 2015 vlerësohet

671 689 nr. i të infektuarve dhe 33.100 vdekje. Ndikim ky i krahasueshëm me efektin e akumuluar të gripit, tuberkulozit dhe të SIDA-s për të njëjtën periudhë, ndikim i cili më i madh është në Itali dhe Greqi. Mjeket hedhin alarmin mbi rrezikun që vjen pikërisht nga nenkonsumimi (marrja afatshkurtër)

ose superkonsumimi i antibiotikeve , ku që te dyja bëjnë bakteret rezistence. Po ashtu dhe ne Australi ne shtator 2017 u vërejt një përhapje e një bakteri super rezistent nga të gjithë antibiotiket e njohur deri me sot- si stafilokokus epidermitis që shkakton sëmundje të rënda dhe vdekje i ngjashëm me stafilokokun aureus rezistent ndaj Methycilines - 2/3 e infeksionit vinin me origjinë nga spitalet , e cila e bën me alarmante situatën dhe nevojën për një trajtim alternativ, Problemi duhet të përqendrohet tek një përdorim i përshtatshëm i antibiotikeve (për njerëzit dhe për kafshët) si pjese e mjeteve të luftës kundër këtij kërcënimi serioz.

OBSH hedh alarmin për suprabaktere që me këtë rritje zhvillimi supozohen afro 10 milion të infektuar çdo vit përfshi dhe TRB rezistent deri ne vitin 2050. Drejtori ekonomik i OBSH Jim O'Neil thekson se fenomeni


shkakton 700.000 vdekje ne vit ne të gjithë boten ku 500.000 prekun Evropën dhe SHBA. Pra shtrohet problemi i gjetjes se trajtimeve te reja. Rezistenca bakteriale mund te prek cilin do dhe kudo, nuk ka rendësi moshë apo vendndodhja. OBSH ka bere një seri përpjekjesh që ne bote te mos mungojnë antibiotiket ne vitet e fundit po ashtu dhe agjencia ONU ju ka kërkuar shteteve investime ne këtë drejtim. Nevoja për antibiotike te ri është urgjente , përball këtij kërcënimi te rritjes se baktereve rezistente ndaj mjekimeve konstatohet mungese e madhe e antibiotikeve te ri veprues dhe duhet te zhvillohen dhe forma orale te tyre për trajtimin ambulator. Kjo është një urgjence botërore që rrezikon seriozisht përparimin e mjekësisë moderne sipas drejtorit të përgjithshëm të OBSH Tedros Allanom Ghebreyesus, ai u kërkoj shteteve te shtojnë investimet ne kërkime për zhvillimin koherent te luftës kundër baktereve multirezistente përfshi dhe TBC. Plani i veprimit duhet te jete gjithë botëror kundër antibiotiko -rezistences sepse OBSH shprehu fundin e antibiotikeve dhe hapi "ere pas antibiotikeve" .., ndryshimi nuk pret. Të gjithë njerëzit e kanë një rol që ta luajnë që tani. Duhet te kontribuojnë ne uljen e përdorimit te antibiotikeve,

që te kufizohet rezistenca ndaj tyre. Një higjienë e mire është një mjet efikas për ta parandaluar dhe pakësuar këtë rezistence. Nga ana tjetër nëse merrni një recete me antibiotike kundër një infeksioni bakterial duhet ta merrni rregullisht sipas këshillave qofte dozën prokursus (TOTALE)-te paktën për 7 dite) qofte sipas afatit çdo 6-ore apo 8-ore dhe kura te çohet deri ne fund. Pra zbatoni udhëzimin e mjekut dhe te farmacistit. Duhet te dini që bakteret janë tinëzarë dhe ato përpriqen me çdo kusht dhe mjet te bëjnë rezistence që te mbijetojnë ndaj rrezikut kërcënues te antibiotikeve dhe kjo lloj gjendje përjetohet, kur ilaçet antibiotike merren shpesh , nuk përdoren deri ne fund apo kur merren pa vend si ne rastet e gripit apo infeksioneve te tjera virale ku dihet se ato nuk veprojnë ndaj viruseve, ato u janë prodhuar që te veprojnë vetëm kundër baktereve , viruset janë intraqelizore mikroskopik. Doza e antibiotikut duhet te llogaritet për kg / peshe ne mënyre te sakte për sasinë ditore por dhe si zgjatje mjekimi mesatarisht jo me pak se 7 dite kohe e cila duhet te shkatërrojë plotësisht bakterin. Nëse ju nuk zbatoni udhëzimin e mjekut ose te pasaportës se ilaçit që merrni, qofte për dozën ditore apo kohëzgjatjen e mjekimit rrezikoheni që ky antibiotik te mos u veproje me ne te ardhmen , duke krijuar rezistence. Sqarohuni mire për çdo paqartësi me mjekun apo farmacistin si dhe kur rastis ndonjë fenomen anësor, që iu jep medikamenti mos e neglizhoni! Disa antibiotik nuk përshtaten as për moshën

e as për individin dhe tek disa persona te tille japin efekte anësore si te vjella, nauzea, heqje barku apo shfaqje ne lëkure me puçrra dhe me kruajtje etj. Kështu Ceporinat e gjeneratës se 2-3 shpesh japin diarree te zhvilluar nga një mikrob i shfaqur ne zorre si Clostridium difficile me prioritet primar , prandaj këto ilaçe duhet te shoqërohen me metronitazol (flagyl) për te pervenuar diarre. Ne rastet kur ju ndiheni me keq apo keni çrregullime si me sipër njoftoni mjekun apo urgjencën 127. Mos bëni gabim tu jepni te tjerëve nga ilaçet tuaja pjesëtarë te familje apo miq sikur po ndani një molla, sepse mund te përballeni me pasoja te rrezikshme për jetën, as mos e bëni këtë veprim ne asnjë lloj situatë! Mos mbani rezerva mbetjesh ilaçe te pa përdoruar ne shtëpi, tepriat mos i përdorni por mundësisht as digjni apo dërgojeni tek farmacia me e afërt për ti hedhur sipas rregullave ne fuqi. Te gjithë ne kemi diçka për te bere ne drejtim te rezistencës bakteriale. Se pari duhet:

- Informohuni
- Mblidhni te dhëna,
- Parandaloni infeksionin *mbani higjienën * vaksinohuni kundër gripit
- Rregulloni regjimin e ilaçeve sipas normave
- Investoni sipas mundësive ne këtë drejtim.

Përgatitur e përshtatur nga Dr Med Ndue Nikaj, Shkodër



*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***



TAHIR BEZHANI - Gjakovë

TË VDESËSH I DEHUR....

Ka kohë që mendohem
Ditën e natën shqetësohem
Kur më turren aq zjarrshëm sytë e tu
E në qenien time shprushin kujtime

Shikimet lënë vrima të hapura
Kullojnë lotët, përplasnin ngrirjen e ashtit
Puthjet e një kohe zjarr e shkruam
Edhe tani ende ka zjarr nën hirin e fjetur

Në shtratin e bukurisë së paharruar
Në dukje i fikur, tymon e flet me mall
Si shikimet tua që shpojnë prore
Si gacat e mbuluara që djegin shpirtin

Dëshirat rrinë në pritje gjithherë...
Eja, eja e puthëm, mos shiko e ndrojtur
Dehu, dehu fort
S'ka gjë më të bukur se vdekja i dehur

Po të takova viza vizë me vdekjen
Pa puthjen tënde nuk iki andej
O Khajam i shkretë
Si e pive gjithë atë verë në jetë
E mbete kurrë i pa vdekur?!...

KUR NATËN NUK FLEJNË MENDIMET

Pas lodhjes së ditës
Tretur rrugëve të mundimshme të jetës
Prita i gëzuar natën që vjen me heshtjen
Me flladin e shlodhjes mashtruese, pushim bebëzave

Qeshjet e natën janë gaz i ditës së iku
Në shtratin tim shpesh jam trembur në ëndrra
Krismat të lehta binin në derën e çarë, pa rezë
Hije njerëzish pa trajta, zgërdhieshin

Donin dhunshëm të merrnin thesarë të fshehur
Pa bërë aspak luftë me shpirtin kryeneç
Të padorëzuarin e mendimeve të mia
Që kishte kallë pesë gishtërinjtë e dorës

Për të dhënë dritë në dhomën time
Nuk di kah iku nata, kah u tret e paparë
Mbeta i uritur, nuk ia thashë dy-tre fjalë
Sillem vërdallë shtratit me dhimbjet që s'bëzajnë

Vetëm flaka e gishtërinjtë bëjnë dritë
Në mungesë të qirinjtë të vjedhur
Sa më janë nxirë thonjtë e mishi rrjedh lëng
A ka më bukur se të jetosh me vuajtjen e vuajtjes

Luftë mes njerëzve për pasuri e karrige
A ka më fisnikëri, më thoni
Më thoni se ku ka?!...



PREND BUZHALA nga Klina

KU JE

Ku je, -
Bërtet nëpër stacione autobusësh,
trenash, aeroportesh,
thërret e thërret nëpër sa e sa celularë:
Ku je
Klithma, një pyetje therëse rend nëpër dekada.
I ther muajt, vitet, ditët: Ku je?

Mandej betohet se më nuk do të kërkojë,
as nuk do të bërtasë.

Dikur nisi të mos e njohë më veten,
As shtëpinë, as botën, as jetën.
Pamjet me klithma vizatohen në qiell,
në udhë, në shtëpi,
Nuk kishte dëshirë të fliste për to,
as çka kërkon të mos i thoshte as vetes.
Nuk dëshironte të fliste
për asnjë ngjarje të së kaluarës therëse.

Nuk fliste.
Klithte: Ku je?
Ku je? E emra nuk përmendte.

I thanë: Ku ishe ti në luftë?
Vetëm tha: Krejt çka pata, dhashë.
Ishte i vetmi bir
që u zhduk si luftëtar bashkë me erën.

S'iu dorëzua Njeriut. Para Njeriut heshte.
Therjet e klithmës shkaktajnë gjakderdhje,
secila ditë skuqet nga Gjaku i Derdhur.

Pyeti Perëndinë: Ku je?
Askush nuk e di si e mori përgjigjen e parrëfyer.
- Po, nisem, e di ku je!
Dhe iu dorëzua Perëndisë.

BALADË PËR NGUSHËLLIMIN

Zot, kur na mungojnë më të dashurit tanë
dërgoje atje, në Botën e amshuar
tejmallin tonë, si zë i tejshpirtit,
dërgoji atje sytë tanë, kujtimet tona,
pikën tonë të gjakut, grimcën tonë të frymëmarrjes,
Fjalën Tonë të Zembrës.

Ndryshe, Paqja e Përjetësisë as atje nuk ka kuptim
nuk është e bukur pa ne.
As në këndejbote, pa ta, asgjë nuk ka kuptim.

Zot,
të na falin pse trishtimi i humbjes nuk zhduket
as kur vjen Ditë e Re,
dhe e presim Një Ditë kur do ta kemi
Shtëpinë e Përbashkët
atë vatër pa caqe, pa mure.

Zot, ende i dëgjojmë zërat e të dashurve tanë,
kur na thonë:
vetëm te Shtëpia e Atit kemi kaluar.

E u themi:
lutuni për ne të këndejboshmit
të këndejuvajturit, të këndejshtetësuarit.

A thua, a do të ketë edhe andejbotshëm
përsëri Çaste të Ndarjes së tillë?
Vetëm në Tokë Ndarjet e tilla kanë kuptim,
kur të dashurit na ikin pa lamtumirë.

Kur qëndrojmë gatitu a ulur te varret e tyre,
na thonë:
po gaboni, ne këtu nuk flemë,
ne gjendemi te një rreze dielli që bie mbi botë,
te pikat e shiut që bien mbi drithëra e mbi barë,
te një fjalë e urtë marrim frymë,
te një emër i trashëguar ashtnie,
te zgjimet e hershme mëngjesore
të qetësisë parajsore.

Mund të na shihni te yjet,
te drita e tyre aq e butë,
ndoshta te një fluturim shqiponje.
E na pëshpëritin:
Ne nuk flemë.



REXHEP ABAZI nga Medvegja

DITË E MADHE E ALFABETIT

Gjuha shqipe, gjuhë e Zotit
E stërnipave të Kastriotit
Tubon burrat e këtij kombit
Dijetarë si pika e lotit

N'Manastir qytet shqiptar
Për të bërë një punë të mbarë

Që kjo gjuhë të shkruhet n'letër
Siç po shkruhej çdo gjuhë tjetër
Gjetën shkronja, bënë alfabet
Për të shkruar ate që flet

Sot njëqind e dymbëdhjetë vjetë
Gjuha shqipe ka alfabet
Paçin dritë ata që e bënë
Trashëgim që na kanë lënë

PËR GJYSHIN QË NUK E NJOHA

E more gjyshi im
Nuk pata fatin të të njihja
Edhe pse do të doja shumë
Ti shkove në botën tjetër
Kur unë isha foshnje në gjumë
Më thanë se ishe gëzuar shumë
Kur unë kisha lindur

Por mua më mungoi
Përkdhelja e dorës sate
E kjo më rëndoi në jetë
Sikur të kisha parë një herë
E të kisha përqafuar
Do më mjaftonte së paku
Sa për të përkujtuar
Eh more gjyshi im
Të gjithë më thonë se ishe i mirë
Të gjithë më thonë se ishe i mençur
Të gjithë më thonë se ishe i urtë
Të gjithë më thonë se ishe trim
Të gjithë më thonë se ishe punëtor
Të gjithë më thonë se e doje mirësinë
Jo vëtëm për veti por për njerëzinë
Thonë se vendlindjen e deshe shumë
E atdheun e kombin mbi të gjitha
Thonë se shite sexhaden e shtratit
Për të blerë livadhin e Starabajës
Që ne, pasaddhësit tu
Të jetonim më mirë
Dhe jetuam shumë mirë
Deri sa ishim në tokën tënde
Deri sa ishim në shtëpinë tënde
E sot kur nga vendlindja ikëm
Nuk jetojmë më mirë
Jetojmë me brenga e mërzi
Për at vend që ti na le trashëgimi
E që ne nuk e ruajtëm
Ia kthiem shpinën
Duke mos ia ditur vlerën
Duke thënë se vendet e tjera
Janë më të mira
Dhe shkuam atje e i pamë
Atje gjumin s'ë bëmë të qetë
Shpirtin e kemi të trazuar
Zemrën të zbrazët
E sytë gjithnjë të përлотur
Eh more gjyshi im i dashur
Ndoshta është më mirë
Që nuk na sheh kështu
Të katandisur e të thyer
Në vendet e huaja bredhim
Pa shpresë e ardhmëri
Pa gëzim e lumturi
I morëm në qafë edhe fëminë
I sollëm në vendet e huaja
Në vendet ku nuk i shohin
Bukuritë e atdheut
Ku nuk e dëgjojnë gjuhën tënde
As gjuhën time
As gjuhën e nënës tënde
As gjuhën e nënës sime
E ne i ikim përgjegjësisë
I fajësojmë ata pse nuk po e flasin këtë gjuhë
Në Gjermani, në Amerikë e Angli
Po more gjyshi im i dashur
Çfarë rëndësie ka të flitet shqip atje
Gjermani nuk na kupton
Amerikani jo se jo
Anglezi edhe më hiq
Kanë ata gjuhët e tyre
E ne nuk jemi më në vendin tonë
Ku do t'na kuptonte Presheva, Medvegja e Bujanoci
Ku do t'na flisnin me gjuhën tonë
Eh more gjyshi im i dashur
Ndoshta ti edhe na sheh
Në çfarë sikleti e çitëm vehten
Po aq më keq fëmijët tanë
Ty të dhemb shpirti kur na sheh kështu
E neve do na dhemb e sotmja dhe e ardhmja



IDRIZ BERISHA - XHIXHI, nga Klina

MËNGJES I PREMTUAR

Në agun e dashurisë
dritaret prekin sy e buzë,
shartohen të freskëta meditimet
rrugëve t'pashkelura valëlumit
mbi pluhur kallen flakë.

Mëngjesit të premtuar
japin dritë dritëzuar,
qëndisimat e qiellit blu
në këmbim të frymëmarrjes
zhveshin amësinë parajsore
ditës i thonë mirësëvjen.
Si hënë e nusëruar me fije flokësh
qep e shqep dashuri
aromë rrobash si krua prrojesh
mbulon fytyrën nga syri im
vargjeve u jep vetminë
mbi ujvarat e përroit harruar.

Patëm lënë takim bese aty
po blerimet avulluan
Tej brigjeve u fsheh psheretima
mëkatuan edhe para nesh
dashnorët me sy qielli

KOHË ËNDRRASH

Mbrëmë
befas në ëndërr me erdhe
treni i fundit të solli
me shpirtin të ndezur flakadan.
As burrë as hije nuk ishe
heshtjën theve kur terrin puthe
dhe kohen trete në pakthim
pikturë e bëre anonim!

Ora e murit ,vetminë ndjek
akrepave u del në pritë
Matanë bjeshkëve kur ike
Erë u bëre
Stuhi u bëre.
Me le mua obelisk ,strofull për zogj
të jetoj qerpikëve tu
netëve të vona,
agmisë së kuqe
Simfoni lotësh
Ëndrrat mi mbledh përrojeve
Në cep ure me gjenë
Të Drini bardhë me valë shumë.

TROKËLLIMË APOKALIPSE

Zjarr që lule e tokë djeg
amfiteatër i ndezur n'univers
shfaqje morbide pa shumë fjalë
nis marsit rilindur
e prilleve thanë lule njoma
planetin nxinë me lot valë.

Statujat mbijnë horizonteteve
mbijnë kudo në dritë e në terr
pa frikën e jetës

bëjnë hapa drejt sheolit
vdekjes gatitu u rrijnë.

Emblema si diell i kuq
Gjëmon, fikë drita e flamuj djeg
Apokalips direrian
Trokllimë si ujë uritur
shpirtin të varur universeve.
Një ditë e ate ditë
Vdekja do të vdes maje Olimpi
Hej!
Ditët hyjnisht do i numërojmë
Vërtetë lindjeve do t'u qeshemi
për një ditë
për një orë
për një çast
Bota do mbushet me lule.



LULASH BRIGJA

TAHIR BEZHANIT

Livallin e bukur të jetës
Qendisur në leksione auditore e seminare
Ngjyrosur ne nuanca te forta historie
Nën tingujt e jareve Gjakovare
Diku në Çarshinë e vjetër..
Rrënjët gjenetike me ty më përpjekën
Vitet e shekujt ecin kalojnë.
Por gjurmët e gjakut prap diku mbeten
Disa shkronja që mu duken si poezi
Thellë në shpirtin i paskam shkruar.
Me to po mbush gotën e kujtimeve
Të uroj nga larg dhe të them Gëzuar.

PROFESOR REXHEP ABAZI

Shtatn e rriti në Luginë
Me çizmen e hasmit mbi shpinë
Me sy në Kosovë , me zemër Shqiptare
Me emra ilir në shtëpi e në varre.
Në Preshevë e njohin profesor Rexhepi
Që gjithmonë një liber i gjendet me vedi.
Edhe nëse vdes thotë ta kem deshmi
Se jam Shqiptar që jetoj n' Serbi
I kujtoj takimet kur flisje ngadalë
Heshtur dhe menduar si flokët e bardhe
Me shpresë dhe besim si gjithë Shqiptaria
Se heret a vonë vendoset drejtësia..

IDRIZ BERISHA- XHIXHI

Në vjeshtën tënde të berëqetshme
Si fllad pranvere na troket
O miku im i nderuar.
Profesor , piktor dhe poet
Celsin e viteve e ke humbur
Duke kërkuar të bukurën në art
Zemrën e holle piktur në telajo
Shpirtin e bëre poezi në varg
Si diedhi që puthet fushës me lulet .
Si hëna që puthet me mrrizat në male .
Ashtu dhe pena jote e arte
I puth kudo trojet Shqiptare..

PRENDI I KLINËS

Mbi hapat e tua të qetë
Rëndon historia e Dardanisë
Babai i fjalës të shkruar
Mjeshtër i vargut dhe i poezisë
A thua Sokratit ja ke marrë
Imazhin urtësinë dhe mençurinë
I dashur me plakun me poetin
I ëmbël me natyrën dhe me rininë
Sa herë shkoj tek biblioteka
Flas me librat dhe të bëj të fala.
Krenohemi që të kemi mik dhe koleg
Krenohet Kosova me ty Prend Buzhala!

TË JETOSH DO TË THOTË...

Të jetosh, do të thotë, të kërkosh të vërtetën e gjërave,
të vërtetën e jetës;
të jetosh, do të thotë, të ecim të sigurtë drejt Qëllimit.
Të jetosh, do të thotë, të besosh në të Pafundmin, në të Pakrijuarin
që të mbështjell me Dashuri.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh i dashur
që nga zanafilla e Krijimit;
të jetosh, do të thotë, të duash... edhe kur nuk merr dashuri.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh brenda një butësie kaq të madhe
saqë pa masë ta zgjeron zemrën.
Të jetosh, do të thotë, ta kesh të qartë, vlerën e pafund të jetës.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh i aftë të shtrëngosh
me një përqaftim të vetëm... me dashuri...
të gjitha gëzimet... të gjitha dhimbjet...
universin... të Pafundmen...
dhe Krijuesin e Tij.

Ps.: Sa bukur do të ishte sikur këto mendime e ndjenja
të mund të këndoheshin në çdo vend!

ZGJOHU, O NJERËZIM!

Mos kaloni asnjë ditë pa dashur dikë,
pa dashur diçka, pa dashur veten tuaj!
Pa një gjest të vogël apo të madh dashurie,
në këtë Planet jeni si të huaj!

Një ditë pa Dashuri është një ditë pa jetë;
një kohë bosh një minutë pa dashuri,
një sekondë pa Të si një çast jo i vërtetë,
pa Shpirtin e Jetës që ju jep liri!

Zgjohu, o njerëzim, zgjohu:
Është një Dashuri që të bën të lumtur!
Zgjohu, o njerëzim, dhe Duaj:
Zgjohu se jeta është kaq e bukur!

Duaj me të vërtetë e bëj çfarë të duash!
E mëso të harrosh, o njerëzim!
Mëso se është një rrugë e bukur para teje,
rruga e Paqes së zemrës, vëllai im!

Se për të dashur ti ke qenë krijuar!
E duke dashur Paqen të gjes,
ndërsa je duke luftuar për Paqen,
çdo luftë, me gëzim, në PAQE ta kthesh!

TË JETOSH DO TË THOTË...

Motër Carmina Schieda

Të jetosh, do të thotë, të kërkosh të vërtetën e gjërave,
të vërtetën e jetës;
të jetosh, do të thotë, të ecim të sigurtë drejt Qëllimit.
Të jetosh, do të thotë, të besosh në të Pafundmin, në të Pakrijuarin
që të mbështjell me Dashuri.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh i dashur
që nga zanafilla e Krijimit;
të jetosh, do të thotë, të duash... edhe kur nuk merr dashuri.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh brenda një butësie kaq të madhe
saqë pa masë ta zgjeron zemrën.
Të jetosh, do të thotë, ta kesh të qartë, vlerën e pafund të jetës.
Të jetosh, do të thotë, të ndihesh i aftë të shtrëngosh
me një përqaftim të vetëm... me dashuri...
të gjitha gëzimet... të gjitha dhimbjet...
universin... të Pafundmen...
dhe Krijuesin e Tij.

Ps.: Sa bukur do të ishte sikur këto mendime e ndjenja
të mund të këndoheshin në çdo vend!
Përktheu: Nikolin Sh. Lëmezhi

Nikolin Sh. Lëmezhi

SHOKU I KLASËS

Shoku im i klasës
por si ai nuk ka
E doja me zemër
vëlla përmbi vëlla

Gjithmonë ndejtëm bashkë
kurrë nuk u ndamë
Shok e përmbi shok
vëlla e përmbi vëlla

Ndihmuam njeri-tjetrin
me shumë dashuri
Unë në stomatologji
ai në ortopedi

Së bashku i bëmë
detyrat e shtëpisë
Te dy në stadium
si tifozë të Vllaznisë

Kishim shumë dëshira
se i riu ëndërron
Ai dhe në ëndërr
luante futboll

U deshëm aq shumë
nuk mendova ndarjen
Por nuk e pritëm
corone malarien

Njaci na iku
na tha lamtumirë
Ne, shokët e klasës
kujtojmë mirësinë

Nuk na besohet
kaq shpejt kjo e ikun
Por është në parajsë
me Prelen e Sadikun

MARK BOBNAJ, Shkodë, 21
nëntor2020



REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
Fran Shytani

